



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
INSPEKTORATI SHTETËROR I ARSIMIT

**“INSPEKTIMI DHE VETËVLERËSIMI I SHËRBIMIT
PSIKOLOGJIK NË SHKOLLË”**

TIRANË, 2013

Ky botim u përgatit nga:

1. Prof.Dr.Adem Tamo, pedagog në fakultetin e shkencave Sociale UT
2. Dr.Eglantina Dervishaj, psikologe shkollore
3. Dr.Florian Kulla, psikolog shkollor
4. Dr.Robert Gjedia, specialist arsimit në Inspektoratin Shtetëror të Arsimit, ISHA-Tiranë

Redaktimi shkencor: Prof.Adem Tamo

Redaktimi letrar: Antoneta Ramaj

Falënderojmë për kontributin:

1. Dr.Marsel Cara, pedagog i psikologjisë në UET
2. Arteneida Çuni, psikologe shkollore
3. Manjola Kumria, psikologe shkollore
4. Ilisa Polena, psikologe shkollore
5. Ornela Qendor/Miha, psikologe shkollore
6. Ornela Belba, psikologe shkollore

Copyright: ISHA

PËRMBAJTJA

FJALA E MINISTRIT	Error! Bookmark not defined.
INSPEKTIMI DHE VETËVLERËSIMI I SHËRBIMIT PSIKOLOGJIK NË SHKOLLË	Error! Bookmark not defined.
Fusha I: VLERËSIMI	9
Fusha II: PLANIFIKIMI	21
Fusha III: KONSULTIMI DHE BASHKËPUNIMI	30
Fusha IV: KËSHILLIMI.....	42
Fusha V: ZHVILLIMI PROFESIONAL I PSIKOLOGUT SHKOLLOR	52
BAZA LIGJORE.....	61
BIBLIOGRAFIA.....	61
WEBLIOGRAFIA.....	62

Të dashur psikologe dhe psikologë shkollorë,

Të nderuar drejtuese dhe drejtues të shkollave,

Vitet e fundit po zbatohen reforma të thella në shkollat e arsimit parauniversitar. Ato janë iniciativa të reja, të guximshme dhe përpjekje, të cilat po i japin shkollës më shumë autonomi, liri profesionale dhe të drejta në vendimmarrje.

Një nga përgjegjësitë e shkollës është edhe ofrimi i shërbimit psikologjik, tashmë i sanksionuar në Ligjin e ri të Arsimit Parauniversitar.

Roli i psikologut shkollor është i rëndësishëm në shkollë. Shërbimi i tij ofrohet nëpërmjet trajtimit të problematikave të ndryshme, vlerësimit të rasteve të fëmijëve me nevoja të veçanta psiko-sociale, si dhe me anë të hartimit e të zbatimit të programeve parandaluese, sipas nevojave të komunitetit shkollor.

Shoqëria jonë është e lirë dhe e hapur ndaj risive, por edhe ndaj problemeve të shumta shoqërore, ekonomike, shpirtërore, individuale. Në këtë proces, psikologët janë më afër se kushdo tjetër me fëmijën, adoleshentin-nxënës dhe problemet e shumëllojshme të tyre. Nga ana tjetër, psikologu shkollor jep një kontribut të ndjeshëm te çdo nxënës për të përballuar me sukses kurrikulën, përmbajtjen, synimet dhe objektivat e saj. Janë psikologët, të cilët së bashku me mësuesit, lehtësojnë përpjekjet e nxënësve për të përfunduar me sukses shkollimin e tyre.

Udhëzuesi “Inspektimi dhe vetëvlerësimi i shërbimit psikologjik në shkollë” është një material i posaçëm, profesional që vjen për herë të parë te psikologu shkollor, me tregues të matshëm dhe instrumente pune, që i tregojnë atij elementet e domosdoshme të shërbimit psikologjik.

Gjithashtu, udhëzuesi krijon mundësi për të realizuar një vetëvlerësim dhe vlerësim të jashtëm të shërbimit psikologjik në shkollë. Ky është një proces që kërkon kohë, përpjekje dhe angazhim profesional, por mbi të gjitha, një kombinim të frytshëm të vetëvlerësimit, që ju do të zhvilloni vit pas viti për shërbimin tuaj, me vlerësimin e jashtëm që zhvillohet nga Inspektorati Shtetëror i Arsimit.

Nëpërmjet këtij udhëzuesi, që ofron mbështetje dhe synon përmirësimin e cilësisë së shërbimit psikologjik në shkollë, hidhet një hap i sigurt në rrugën e pandalshme drejt përmirësimit të cilësisë në sistemin arsimor.

Ju uroj të gjithëve suksese dhe mbarësi!

Myqerem TAJAJ

MINISTËR

INSPEKTIMI¹ DHE VETËVLERËSIMI I SHËRBIMIT PSIKOLOGJIK NË SHKOLLË

Procesi i vetëvlerësimit² dhe ai i vlerësimit të jashtëm të shërbimit të psikologut³ shkollor kërkon përdorimin e një metodologjie shkencore, të qartë, të besueshme dhe bashkëkohore, e cila siguron të dhëna reale dhe pasqyron pikat e forta, pikat e dobëta, si dhe mundësitë që ka psikologu shkollor për të ofruar një shërbim profesional cilësor, e, në veçanti, mbështetjen e nevojave për përmirësimin e tij në të ardhmen.

Nga ana tjetër, përdorimi i së njëjtës metodologji dhe i të njëjtëve tregues nga psikologu shkollor, nga ekipi i vlerësimit të brendshëm të institucionit arsimor, por edhe nga ekipi i vlerësimit të jashtëm (Inspektorati Shtetëror i Arsimit) është një mënyrë që përafron këto dy vlerësime, të cilat synojnë përmirësimin e shërbimit psikologjik dhe përcaktimin e nivelit të cilësisë së tij.

I rëndësishëm mbetet qëllimi i Inspektoratit, për të zhvilluar hap pas hapi në institucionet arsimore parauniversitare kulturën e vlerësimit të brendshëm. Kjo është një që kërkon njohje dhe zotërim të standardeve profesionale dhe etike të vlerësimit, angazhim dhe përgjegjësi të të gjithë personave të përfshirë në vlerësim, të ekipeve të vlerësimit të brendshëm, të psikologut shkollor në veçanti, si dhe të autoriteteve e organizmave drejtues të institucionit arsimor.

Cilat janë elementet e metodologjisë së vetëvlerësimit dhe të vlerësimit të jashtëm të shërbimit të psikologut shkollor?

1. Përcaktimi i fushave dhe i nënfushave të vlerësimit të shërbimit të psikologut shkollor

Fusha nënkupton një drejtim apo dimension themelor të veprimtarisë së psikologut shkollor. Fusha lidhet drejtpërdrejt me zbatimin e standardeve profesionale, si dhe gjithë veprimtarinë e tij profesionale. Përcaktimi i fushave të veprimtarisë bazohet në aktet ligjore dhe nënligjore të arsimit që lidhen me shërbimin psikologjik në institucionet arsimore parauniversitare.

Janë përcaktuar 5 fusha kryesore të vlerësimit:

Fusha I: Vlerësimi

Fusha II: Planifikimi

¹ Inspektimi në këtë material nënkupton vlerësimin e jashtëm të shërbimit psikologjik.

² Vetëvlerësimi nënkupton vlerësimin e brendshëm.

³ Psikologu shkollor nënkupton dhe psikologjen.

Fusha III: Konsultimi dhe bashkëpunimi

Fusha IV: Këshillimi

Fusha V: Zhvillim profesional

Nënfusha është një nënndarje, detajim dhe element i domosdoshëm që tregon dhe plotëson më së miri përmbajtjen e një fushe të caktuar, për të cilën punon psikologu shkollor. Konkretisht, nëse një nga fushat e shërbimit psikologjik është “**Vlerësimi**”, detajimet apo nënndarjet për të janë: a) **Procesi i vlerësimit**, b) **Etika në vlerësim**. Këto synojnë të identifikojnë se çfarë ndodh me vlerësimin që ofrohet nga psikologu shkollor dhe, nga ana tjetër, plotësojnë të gjitha elementet që ka kjo fushë. Këto nënndarje apo detajime konsiderohen si një mundësi për të identifikuar, për të vëzhguar dhe për të vlerësuar me imtësi atë që kryen psikologu shkollor. Pra, detajimet kryejnë dy funksione:

- a) zbërthejnë fushën në elemente organike dhe të domosdoshme për të,
- b) mundësojnë një njohje dhe vlerësim real të situatës së shërbimit psikologjik në institucionin arsimor parauniversitar.

2. Përcaktimi i një sistemi treguesish të vlefshëm, të dobishëm, të mjaftueshëm, të matshëm dhe të përdorshëm

Treguesi shprehet me një fjali të matshme, pohuese që tregon si është dhe si duhet të jetë niveli i fushave. Nëpërmjet treguesve arrijmë të vlerësojmë cilësinë e shërbimit psikologjik në shkollë. Treguesi ka këto veçori:

- hartohet për secilën nënfushë dhe mund të jenë një apo disa;
- është gjithnjë i matshëm, (që do të thotë se lehtëson procesin e vetëvlerësimit dhe të inspektimit të tij);
- paraqet pohime që cilësojnë fushën që do të vlerësohet.

P.sh.:

Nr.	FUSHA	NËNFUSHA	TREGUESIT (shembuj)
I	Vlerësimi	<ul style="list-style-type: none">Procesi i vlerësimit	<ul style="list-style-type: none">Psikologu shkollor zhvillon procedura vlerësimi sipas planifikimit, duke realizuar të gjitha hapat e duhur profesionalë.
II	Planifikimi	<ul style="list-style-type: none">Praktika e planifikimit	<ul style="list-style-type: none">Psikologu shkollor kryen një sërë aktiviteteve planifikuese.
III	Konsultimi dhe bashkëpunimi	<ul style="list-style-type: none">Koncepti mbi konsultimin	<ul style="list-style-type: none">Psikologu shkollor ofron konsulencë për mësuesit.
IV	Këshillimi	<ul style="list-style-type: none">Praktika e këshillimit	<ul style="list-style-type: none">Psikologu shkollor përfshihet në veprimtari këshilluese individuale e në grup për aktorët shkollorë e jashtëshkollorë.
V	Zhvillimi profesional	<ul style="list-style-type: none">Informimi për zhvillimet në fushën profesionale	<ul style="list-style-type: none">Psikologu shkollor është i informuar për risitë dhe përvojat bashkëkohore të shërbimit psikologjik në shkollë.

Instrumenti i vëzhgimit⁴ shprehet me një fjali që përcakton se si zbatohet, zhvillohet apo në ç'gjendje paraqitet treguesi i synuar. Nëpërmjet instrumenteve/përshkruesve mblidhen informacione dhe të dhëna për plotësimin e treguesve të shërbimit psikologjik.

Shkallë vlerësimi janë nivelet që përdoren për të vlerësuar shërbimin psikologjik përmes fushave të saj. Nivelet e vlerësimit janë katër: *shumë mirë* që i takon numrit 1, *mirë* që i takon numrit 2, *mjaftueshëm* që i takon numrit 3 dhe *dobët* që i takon numrit 4. Skema me katër shkallë vlerësimi është mjaft e përdorur në vlerësimet që u bëhen shërbimeve të shumëllojshme profesionale në sistemet arsimore evropiane. Po ashtu, ky sistem me katër shkallë mundëson një vlerësim real dhe përfshin të gjitha nivelet që mund të arrijë psikologu shkollor, nëpërmjet shërbimit që ai ofron, sipas treguesve.

⁴ Instrumenti i vëzhgimit është përshkrues i treguesit.

Standardi i vlerësimit është përshkrimi i gjendjes së shërbimit psikologjik për secilën fushë. Ai mundëson një vlerësim sipas niveleve të përmendura më lart. Ky vlerësim është rezultat i përpunimit të të dhënave nga instrumentet e vëzhgimit dhe të vlerësimit që i bëhet secilit tregues, por edhe i të dhënave të siguruara nga metodologjia e zbatuar gjatë vetëvlerësimit apo inspektimit në përgjithësi. Vlerësimi përfundimtar për fushën bazohet gjithnjë në peshën dhe rëndësinë që ka zbatimi i secilit tregues në gjendjen e shërbimit psikologjik.

Fusha I: VLERËSIMI

Vlerësimi përbën një nga fushat kryesore të punës së psikologëve shkollorë. Vlerësimi nënkupton mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, në lidhje me funksionimin psikologjik të individëve e grupeve, përparimin shkollor, si dhe me ecurinë e ndërhyrjeve të caktuara psikologjike e edukative. Vlerësimi nuk mund të ngatërrohet me testimin. Ai nënkupton përdorimin e instrumenteve/teknikave për mbledhjen e të dhënave, modifikimin e instrumenteve ekzistuese, interpretimin e të dhënave dhe raportimin ose përdorimin e mëtejshëm të tyre (testet përbëjnë vetëm një nga instrumentet për grumbullimin e të dhënave për të kryer vlerësime).

Informacionet që sigurohen nëpërmjet vlerësimeve mund të shërbejnë për përdorim të brendshëm ose për përdorim publik. Në këtë manual, ato përdoren si bazë për të marrë vendime, për përcaktimin e nevojave, raportimin dhe për të bërë ndërhyrje të nevojshme.

Komponenti i parë që psikologët shkollorë vlerësojnë, është përparimi i nxënësve. Këto vlerësime ofrojnë të dhëna për arritjet shkollore të nxënësit në lëndë a grupe lëndësh dhe në semestra ose vite shkollore. Ato përdoren për të zbuluar fushat në të cilat mund të bëhen përmirësime, për hartimin e programeve për trajtimin e vështirësive, për të kërkuar burimet e këtyre vështirësive etj.

Komponenti i dytë që psikologët shkollorë vlerësojnë, është vlerësimi i funksionimit të individëve e të grupeve. Psikologët shkollorë kanë formimin e nevojshëm për të vlerësuar funksionimin mendor, emocional dhe sjelljen e nxënësve, për të zbuluar probleme të mirëqenies psikologjike të tyre. Të dhënat e siguruar nga vlerësime të tilla përdoren për t'i ndihmuar ata që të zhvillojnë stile të shëndetshme jetese, sjellje përshtatëse, të përballojnë streset e jetës, të balancojnë më mirë përparimin shkollor, jetën në familje e në shoqëri.

Komponenti i tretë i vlerësimeve që kryejnë psikologët shkollorë, është vlerësimi i ndërhyrjeve të caktuara psikologjike dhe edukative. Të dhënat që sigurohen nga vlerësimi i ndërhyrjeve të caktuara, përdoren për të përcaktuar, nëse kanë dhënë rezultatet e parashikuara apo jo dhe për t'i përmirësuar ato.

Psikologët shkollorë i realizojnë vlerësimet nëpërmjet studimit të dokumentacionit shkollor në formë të printuar dhe elektronike, nëpërmjet vëzhgimeve, intervistave, fokus-grupeve, anketimeve dhe testeve të ndërtuara për këtë qëllim. Në realizimin e këtyre vlerësimeve, ata marrin parasysh kriteret e njohura shkencore për kryerjen dhe interpretimin e tyre, si dhe rregullat e administrimit të rezultateve. Të përdorura nga psikologë pa kualifikimet përkatëse, vlerësimet prodhojnë të dhëna të pasakta, të cilat çojnë në interpretime të gabuara, me ndikime të padëshirueshme në proceset e mirëqenies dhe të arsimimit.

Në punën e vet vlerësuese, psikologu shkollor integron të dhënat e vlerësimit akademik me të dhënat e vlerësimit të sjelljes, për të pasur një pamje sa më objektive të dukurive që ndodhin me nxënësit dhe shkollën.

Nënfushat përbërëse të *Vlerësimit* janë:

- a) Njohuritë dhe zotësitë për vlerësim,
- b) Praktika e vlerësimit,
- c) Etika në vlerësim.

Nënfusha I: Njohuritë dhe zotësitë për vlerësim

Psikologu shkollor duhet të ketë njohuritë e nevojshme për procesin e vlerësimit dhe shkathtësitë përkatëse për të kryer vlerësime. Disa nga kompetencat kryesore të psikologut shkollor në këtë nënfushë janë: a) zotërimi i koncepteve bazike mbi vlerësimin; b) njohja e fushave kryesore, në të cilat ai kryen vlerësimin; c) dallimi i testimit nga vlerësimi; d) njohja e teknikave, kufizimeve dhe e komponentëve kryesorë të vlerësimit.

Nënfusha II: Praktika e vlerësimit

Psikologu shkollor duhet të përfshihet në praktikën e vlerësimit. Në procesin e kryerjes së vlerësimeve nga psikologu shkollor pritet që ai të luajë një rol kyç në: a) planifikimin e vlerësimeve; b) respektimin e hapave të procesit të vlerësimit; c) realizimin e procedurave të vlerësimit; d) përdorimin e instrumenteve të nevojshme në vlerësim; e) dokumentimin e vlerësimit të kryer.

Nënfusha III: Etika në vlerësim

Psikologu shkollor duhet të vlerësojë në mënyrë etike, me përgjegjësi, duke respektuar si të vlerësuarit ashtu edhe rezultatet e vlerësimit, të ruajë konfidencialitetin dhe të administrojë me profesionalizëm të dhënat e vlerësimit.

Nënfusha 1	Treguesit	Instrumentet	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
Njohuritë dhe zotësitë për vlerësim	1. Psikologu shkollor argumenton konceptet e tij kryesore për vlerësimin, si një nga fushat e punës së tij në shkollë.	Psikologu shkollor:				
		1.1.1. Formulon thelbin e procesit të vlerësimit si proces i grumbullimit të të dhënave dhe argumenton nevojën e vlerësimeve.				
		1.1.2. Tregon se i zotëron njohuritë e nevojshme për konceptimin dhe organizimin e procesit të vlerësimit.				
		1.1.3. Përshkruan fushat kryesore të vlerësimeve që kryen në shkollë, si: a) funksionimi psikologjik i individëve dhe grupeve; b) përparimi shkollor; c) ecuria e ndërhyrjeve të caktuara psikologjike dhe edukative.				
		1.1.4. Dallon vlerësimin nga testimi, si pjesë e procesit vlerësues.				
		1.1.5. Është i vetëdijshëm se informacioni i vlerësimeve ndihmon për: a) përcaktimin e nevojave; b) raportimin; c) planifikimin e ndërhyrjeve.				
		1.1.6. Njeh kufizimet dhe avantazhet e teknikave të ndryshme të grumbullimit të të dhënave.				
		1.1.7. Njeh tri komponentët kryesorë të vlerësimit, si: a) përparimi i nxënësve, b) funksionimi i individëve dhe/ose grupeve, c) ndërhyrje të caktuara psikologjike dhe edukative.				
		1.1.8. Argumenton pse për të bërë vlerësimin, duhet të përdorë të dhëna nga shumë fusha.				
		1.1.9. Njeh komplikacionet etike dhe ligjore që lidhen me				

		raportimin e vlerësimeve.				
		1.1.10. Njeh komplikacionet profesionale që lidhen me interpretimin e rezultateve të vlerësimeve.				
2. Psikologu shkollor ilustron konceptet e tij kryesore për vlerësimin, si një nga fushat e punës së tij në shkollë.		1.2.1. Dëshmon se njeh procesin e vlerësimit, si fushën kryesore të punës së psikologut shkollor.				
		1.2.2. Dëshmon se njeh parimet dhe kriteret mbi të cilat bazohet vlerësimi në shkollë.				
		1.2.3. Tregon se zotëron teknikat e statistikës deskriptive (përshkruese) për interpretimin e të dhënave të vlerësimeve.				
		1.2.4. Ilustron përdorimin e teknikave kryesore për grumbullimin e të dhënave për vlerësime, si: a) vëzhgimi; b) intervista; c) fokus grupi; d) anketimi; e) testimi.				
		1.2.5. Ilustron njohuritë e nevojshme për konceptimin dhe organizimin e procesit të vlerësimit.				

Nënfusha 2	Treguesit	Instrumentet	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
		Psikologu shkollor:				
		2.1.1. Siguron lejen e nevojshme për të bërë vlerësimin në institucion.				
		2.1.2. Fillon planifikimin e vlerësimit të nxënësve, vetëm pas marrjes me shkrim të referimit.				
		2.1.3. Kryen konsultë fillestare me përfaqësues të palëve të interesuara, përpara procesit të vlerësimit.				

institucionale, kriteret profesionale, si dhe duke bashkëpunuar me burimet njerëzore, që kanë lidhje me subjektet.	2.1.4. Në raste të caktuara, shqyrton dokumente a dosje të nxënësit, përpara se të vendosë për vlerësimin e tij.				
	2.1.5. Planifikon të fokusojë vlerësimin psikologjik për identifikimin dhe përmbushjen e nevojave individuale të nxënësit.				
	2.1.6. Përcakton kohën, vendin, metodologjinë dhe instrumentet që do të përdorë në vlerësim, sipas rastit të referuar.				
	2.1.7. Merr pjesë në planifikimin dhe zbatimin e skanimeve (screening) dhe programet e vlerësimit për të gjithë nxënësit.				
	2.1.8. Asiston në identifikimin e hershëm të problemeve të nxënësve, që lidhen me përshtatjen dhe të nxënësve.				
	2.1.9. Lidh procesin e vlerësimit me informacionet që merr gjatë konsultave.				
2. Psikologu shkollor zhvillon procedura vlerësimi të planifikuara dhe me profesionalizëm.	2.2.1. Vërteton pjesëmarrjen e tij në procese vlerësuese.				
	2.2.2. Sjell fakte që dëshmojnë pjesëmarrjen e tij në vlerësimin e përparimit të nxënësve në mësim.				
	2.2.3. Sjell fakte që dëshmojnë pjesëmarrjen e tij në vlerësimin e funksionimit të individëve dhe të grupeve.				
	2.2.4. Sjell fakte që dëshmojnë pjesëmarrjen e tij në vlerësimin e ndërhyrjeve të caktuara psikologjike e edukative.				
	2.2.5. Sqaron se procedurat për të gjitha aspektet e vlerësimit janë zhvilluar në konsultim me mësuesit dhe administratorët.				
	2.2.6. Përdor procedura vlerësimi jo diskriminuese.				
	2.2.7. Kryen vlerësimin duke marrë në konsideratë karakteristikat e nxënësit apo grupit të nxënësve (statusit socio-ekonomik, aftësisë së kufizuar etj.).				

		2.2.8. Monitoron sjelljen e nxënësit gjatë vlerësimit, në përputhje me procedurat e sjelljes së psikologut shkollor në procesin e vlerësimit.				
		2.2.9. Mbledh sistematikisht të dhëna për identifikimin e problemit.				
		2.2.10. Përfshin në procesin e vlerësimit psikologjik të nxënësit, jo vetëm administrimin dhe pikëzimin e testeve, por edhe vëzhgime të aspekteve të rëndësishme.				
		2.2.11. Përdor teknika të vlefshme dhe të besueshme në vlerësimin e progresit ndaj objektivave akademikë dhe atyre të sjelljes.				
		2.2.12. Ndihmon në dizenjimin dhe përdorimin e procedurave vlerësuese, për të përcaktuar shkallën e zbatimit të ndërhyrjeve të rekomanduara.				
		2.2.13. Drejton ekipin e vlerësimit dhe merr iniciativën për montimin e materialeve të mbledhura.				
		2.2.14. Bashkëpunon me prindërit, stafin e institucionit dhe persona të tjerë që kanë informacion të vlefshëm për vlerësimin e subjektit.				
		2.2.15. Kryen vlerësimet e duhura në fokus të shqetësimit dhe në përputhje me standardet mbizotëruese profesionale.				
		2.2.16. Është pjesë e ekipeve multidisiplinare në kryerjen e vlerësimeve të nxënësve me aftësi të kufizuara a nevoja të tjera të veçanta.				
	3. Psikologu shkollor përdor instrumente të ndryshme psikologjike për	2.3.1. Demonstron aftësi në përzgjedhjen e mjeteve vlerësuese të vlefshme, formale dhe joformale.				
2.3.2. Përdor teste në përputhje me qëllimin e vlerësimit.						
2.3.3. Merr konsulencën dhe miratimin përkatës për instrumentet vlerësuese që përdor.						

<p>të vlerësuar subjektet, që kanë lidhje objektive me situatat ku ato zbatohen.</p>	<p>2.3.4. Për interpretimin e testeve përdor informacione kontekstuale, të mbledhura përmes vëzhgimeve në klasë, shqyrtimit të dosjes së nxënësit, marrjes së historikut të rastit përmes intervistave, listë-kontrolleve, mbledhjes së të dhënave për funksionin e sjelljes, si dhe rishikimit të vlerësimeve profesionale.</p>				
	<p>2.3.5. Përdor vëzhgimin dhe intervistat si metoda ndihmëse për vjeljen e informacionit në vlerësim.</p>				
	<p>2.3.6. Demonstron aftësi në administrimin, pikëzimin dhe interpretimin e të dhënave të mbledhura nga instrumentet a shënimet e mbajtura.</p>				
	<p>2.3.7. Përdor informacione të ndryshme dhe burime teknologjike për të përmirësuar mbledhjen e të dhënave dhe vendimmarrjen.</p>				
	<p>2.3.8. Zgjedh personat dhe audiencat përkatëse për publikimin e rezultateve të vlerësimeve, si dhe zhvillon seanca informuese dhe sqaruese me kolegët.</p>				
	<p>2.3.9. Vlerësimi psikologjik, i kryer nga psikologu, mund të përfshijë:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) teste (objektive dhe projektive); b) listë kontrolli të sjelljes; c) lista kontrolli vetëraportuese; d) intervista + inventarë; e) instrumente të tjera të besueshme. 				
	<p>2.3.10. Zotëron teknikat e statistikës deskriptive (përshkruese) për interpretimin e të dhënave të vlerësimeve.</p>				
	<p>2.3.11. Përdor teknologji (programe kompjuterike) për të administruar dhe për të interpretuar rezultatet e vlerësimit, në mënyrë profesionale dhe etike.</p>				

<p>4. Psikologu shkollor kryen vlerësimin psikologjik të subjekteve në një mjedis profesional dhe të sigurt.</p> <p>5. Psikologu shkollor harton një raport profesional për vlerësimin psikologjik të subjekteve.</p>	<p>2.4.1. Mjedisi fizik ku kryhet vlerësimi psikologjik i nxënësit, është i mirorganizuar dhe mikpritës.</p>				
	<p>2.4.2. Mjedisi fizik është i sigurt dhe konfidencial.</p>				
	<p>2.4.3. Materialet e nevojshme për vlerësim ruhen në vende të sigurta.</p>				
	<p>2.5.1. Disponon dokumente që tregojnë vlerësime të kryera.</p>				
	<p>2.5.2. Përmbledh në një dokument/raport të plotë, në mënyrë të qartë dhe sipas kërkesave profesionale, të gjitha të dhënat dhe interpretimin e tyre.</p>				
	<p>2.5.3. Raporti i vlerësimit përmban:</p> <ul style="list-style-type: none"> - argumentimin e nevojës për vlerësim; - metodologjinë e vlerësimit të kryer; - pjesëmarrësit; - instrumentet e vlerësimit; - procedurat përkatëse; - gjetjet e vlerësimit; - interpretimin e gjetjeve; - rekomandimet. 				
	<p>2.5.4. Raportet e vlerësimit nuk kanë gabime gramatikore, sintaksore a gabime të tjera gjuhësore, të cilat pengojnë të kuptuarit e përmbajtjes së raportit.</p>				
<p>2.5.5. Gjetjet e vlerësimit lidhen plotësisht me rekomandimet e dhëna.</p>					
<p>2.5.6. Përdor informacionin e vlerësimit për dhënie rekomandimesh dhe marrje vendimesh, në interesin më të lartë të subjektit.</p>					

	6. Psikologu shkollor informon grupet e interesit për rezultatet e vlerësimit psikologjik.	2.6.1. U jep feedback nxënësve, familjeve dhe stafit për rezultatet e vlerësimit.				
		2.6.2. Komunikon rezultatet e vlerësimit të nxënësit, në përputhje me standardet profesionale.				
		2.6.3. Informon dhe u jep feedback nxënësve, mësuesve e personave të tjerë të lejuar.				
		2.6.4. Sigurohet që palët e interesuara të marrin informacionin që rrjedh nga vlerësimi i kryer, sipas rregullave të etikës.				
		2.6.5. Artikulon rezultatet e vlerësimit në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme për audiencën e synuar.				
	7. Psikologu shkollor, bashkë me institucionet arsimore ruajnë dokumentacionin e vlerësimit psikologjik në mjedise të sigurta, për një periudhë kohore 5 -vjeçare, pas largimit të nxënësit nga shkolla.	2.7.1. Raportet e vlerësimit psikologjik ruhen në mjedise të sigurta.				
		2.7.2. Raportet ose protokollat e testeve dhe të mjeteve të përdorura në vlerësime nuk u vihen në dispozicion palëve të treta të paautorizuara.				
		2.7.3. Raportet psikologjike për përparimin akademik konsiderohen pronë publike dhe administrohen nga drejtoria e shkollës.				
		2.7.4. Raportet e vlerësimit psikologjik individual dhe dosjet e nxënësve të vlerësuar ruhen në vende të sigurta dhe përdoren sipas rregullave të shkruara.				
		2.7.5. Në bashkëpunim me autoritetet arsimore përcakton rregulla për administrimin e dosjeve me informacione për procese a individë të vlerësuar.				
2.7.6. Psikologu ka një koncept të qartë për mënyrën e administrimit të vlerësimeve të kryera për individë dhe vlerësimeve të kryera për grupe a procese.						

Nënfusha 3	Treguesit	Instrumentet	Nivelet e vlerësimit			
Etika në vlerësim	Psikologu shkollor përmbush përgjegjësitë etike në vlerësim.	3.1.1. Tregon kujdesin e duhur për miradministrimin e vlerësimeve të kryera.	1	2	3	4
		3.1.2. Është i paanshëm në interpretimin e të dhënave.				
		3.1.3. Informon punëdhënësin për përdorimin e përshtatshëm të instrumenteve dhe të metodave psikologjike në procesin e vlerësimit.				
		3.1.4. Përdor procedura dhe mjete që shmangin diskriminimin krahinor, gjinor, kulturor, fetar a çdo lloj diskriminimi tjetër.				
		3.1.5. Përdor mjete dhe metoda, për të cilat është trajnuar, dhe disponon dokumente për përdorimin e tyre.				
		3.1.6. Përdor instrumente vlerësimi të konsultuara me kolegë.				
		3.1.7. Përdor mjete për vlerësim që janë objektive dhe shkencërisht të aprovuara.				
		3.1.8. Është i vetëdijshëm se instrumentet kanë mangësitë e tyre në drejtim të vlefshmërisë, të besueshmërisë dhe të përdorimit.				
		3.1.9. Është i vetëdijshëm për pasojat e keqpërdorimit të instrumenteve psikologjike.				
		3.1.10. Miradministron vlerësimet e kryera, duke iu përmbajtur ligjeve, udhëzimeve dhe rregullave të kodeve etike në fuqi.				
		3.1.11. Respekton konfidencialitetin për vlerësimet e kryera dhe limitet e tij.				

		3.1.12. Merr masat për ruajtjen e të dhënave dhe respektimin e të drejtave të personave që vlerëson.				
		3.1.13. Raporton vlerësimet e kryera, në individët/organet përkatëse.				
		3.1.14. Përdor rezultatet e vlerësimeve në përputhje me rregullat e etikës dhe aktet ligjore në fuqi.				
		3.1.15. Kryen vlerësime, vetëm pas aprovimit me shkrim të prindit dhe të personave të tjerë të përcaktuar në DN.				

STANDARDI

Psikologu shkollor përfshihet drejtpërdrejt në kryerjen e vlerësimit për ecurinë shkollore të nxënësve (aspektin kognitiv) duke i dhënë përparësi vlerësimit të funksionimit të sjelljes së tyre. Proceset e punës në këtë drejtim përfshijnë, por nuk kufizohen në: planifikimin e vlerësimit të nevojave, në përshtatjen dhe përgatitjen e instrumenteve, në përdorimin e tyre, në grumbullimin e të dhënave, në interpretimin e publikimin e tyre dhe në vlerësimin e ndërhyrjeve të kryera. Vlerësimi i përparimit shkollor dhe i sjelljes kryhet në radhë të parë, për të identifikuar individët që kanë probleme me mësimet dhe me sjelljen. Ky vlerësim është i kombinuar dhe shërben si bazë për rekomandime dhe ndërhyrjet që kryhen në shkollë. Këto procese kryhen si në rastet e rrjedhës normale të jetës shkollore, edhe në rastet e incidenteve serioze.

Niveli 1

Psikologu shkollor pothuajse gjithmonë zotëron, shpreh, argumenton konceptet e tij mbi thelbin, rolin, fushat, teknikat dhe kufizimet e **vlerësimit**, si një nga fushat kryesore të punës së tij në shkollë.

Psikologu shkollor pothuajse gjithmonë zotëron dhe demonstroi përdorimin e një liste të larmishme shkathtësish, për të ofruar vlerësime të frytshme për aktorët me të cilët bashkëpunon.

Psikologu shkollor pothuajse gjithmonë përfshihet në vlerësime dhe përdor instrumente, procedura e teknika të përshtatshme. Pothuajse gjithmonë, ai kujdeset që veprimtaria e vet të jetë e planifikuar dhe e dokumentuar.

Psikologu shkollor, gjatë punës së tij vlerësuese, pothuajse gjithmonë kujdeset që të respektojë nxënësit, privatësinë e tyre, të jetë konfidencial dhe të punojë për interesin më të lartë të nxënësit dhe të institucionit.

Niveli 2

Psikologu shkollor herë pas here zotëron, shpreh, argumenton konceptet e tij mbi thelbin, rolin, fushat, teknikat dhe kufizimet e **vlerësimit**, si një nga fushat kryesore të punës së tij në shkollë.

Psikologu shkollor herë pas here zotëron dhe demonstroi përdorimin e një liste të larmishme shkathtësish, për të ofruar vlerësime të frytshme për aktorët me të cilët bashkëpunon.

Psikologu shkollor herë pas here përfshihet në vlerësime dhe përdor instrumente, procedura e teknika të përshtatshme. Herë pas here, ai kujdeset që veprimtaria e vet të jetë e planifikuar dhe e dokumentuar.

Psikologu shkollor, gjatë punës së tij vlerësuese, herë pas here kujdeset që të respektojë klientët, privatësinë e tyre, të jetë konfidencial dhe të punojë për interesin më të lartë të klientit dhe të institucionit.

Niveli 3

Psikologu shkollor nganjëherë zotëron, shpreh, argumenton konceptet e tij mbi thelbin, rolin, fushat, teknikat dhe kufizimet e **vlerësimit**, si një nga fushat kryesore të punës së tij në shkollë.

Psikologu shkollor nganjëherë zotëron dhe demonstroi përdorimin e një liste të larmishme shkathtësish, për të ofruar vlerësime të frytshme për aktorët me të cilët bashkëpunon.

Psikologu shkollor nganjëherë përfshihet në vlerësime, duke përdorur rrallë instrumente, procedura dhe teknika të përshtatshme në vlerësim. Ndonjëherë, ai kujdeset që veprimtaria e vet të jetë e planifikuar dhe e dokumentuar.

Psikologu shkollor gjatë punës së tij vlerësuese, nganjëherë, kujdeset që të respektojë nxënësit, privatësinë e tyre, të jetë konfidencial dhe të punojë për interesin më të lartë të nxënësit dhe të institucionit.

Niveli 4

Psikologu shkollor rrallëherë zotëron, shpreh, argumenton konceptet e tij mbi thelbin, rolin, fushat, teknikat dhe kufizimet e **vlerësimit**, si një nga fushat kryesore të punës së tij në shkollë.

Psikologu shkollor rrallëherë zotëron dhe demonstroi përdorimin e një liste të larmishme shkathtësish, për të ofruar vlerësime të frytshme për aktorët me të cilët bashkëpunon.

Psikologu shkollor rrallëherë përfshihet në vlerësime dhe përdor pak instrumente, procedura dhe teknika të përshtatshme. Rrallëherë kujdeset që veprimtaria e vet të jetë e planifikuar dhe e dokumentuar.

Psikologu shkollor gjatë punës së tij vlerësuese, rrallëherë, kujdeset që të respektojë klientët, privatësinë e tyre, të jetë konfidencial dhe të punojë për interesin më të lartë të klientit dhe të institucionit.

Fusha II: PLANIFIKIMI

Shërbimi psikologjik shkollor ofrohet në mënyrë të koordinuar, të organizuar dhe të planifikuar, nëpërmjet një procesi zinxhir aktivitetesh dhe bashkësie aktorësh të planifikuar, që e ka pikënisjen te nevojat e aktorëve të përfshirë në proces, duke përdorur të dhënat e mbledhura nëpërmjet vlerësimeve. Psikologu shkollor zotëron njohuri mbi modelet dhe metodat që sigurojnë informacionin e vlefshëm për identifikimin e pikave të forta dhe të nevojave, për zbulimin e problemeve dhe për matjen e përparimit në shkollë. Institucioni arsimor i përdor këto vlerësime për të marrë vendime në lidhje me veprimet ndërhyrëse. Të gjitha ndërhyrjet paraprihen nga veprimtari planifikues. Shkolla është ndër institucionet më të organizuara që vepron, duke kryer veprimtari shumë të planifikuara, por merret edhe me probleme të paplanifikuara në raste incidentesh. Psikologët shkollorë përfshihen në grupet që merren me planifikimin e ndërhyrjeve. Ata japin kontributin e tyre duke qenë pjesë përbërëse e këtyre grupeve dhe, vetëm në raste të rralla, duke punuar individualisht për planifikimin. Proceset planifikuese synojnë ndërhyrje të caktuara. Kontributi i psikologut shkollor në planifikim shprehet, por nuk kufizohet në: pjesëmarrje në grupet e punës, diskutime dhe propozime ndërhyrjesh, raportim të gjetjeve të vlerësimeve, kryerjen e roleve specifike në proceset planifikuese, duke dokumentuar punën e kryer, etj. Shembuj të këtij kontributi janë pjesëmarrjet në planifikimin e trajnimeve, sugjerimet për përmirësime kurrikulare, të fushatave sensibilizuese, të aktiviteteve rekreative, etj.

Planifikimi i shërbimeve psikologjike në shkollë fillon zakonisht pas vlerësimit të nevojave. Vlerësimi i nevojave grupale të nxënësve mundëson zbulimin e çështjeve më të nxehta për të cilat, grupet e ngritura për planifikimin hartojnë agjenda të ndërhyrjes qoftë në nivel shkolle, qoftë në nivel rrethi a qarku. Psikologët shkollorë janë trajnuar dhe këshilluar ta fillojnë këtë veprimtari planifikuese që në fillim të vitit shkollor. Karakteri i aktiviteteve të planifikuara shtrihet që nga ato sensibilizuese, trajnimet psiko-edukative e deri te aktivitetet polivalente kulturore-argëtuese. Ato mundësojnë kombinimin e të dhënave, të siguruara nga vlerësimet, me krijimtarinë dhe fantazinë, duke iu përshtatur në këtë mënyrë nevojave të pikasura dhe psikologjisë së subjekteve (mësues, prindër, nxënës etj.).

Ndërhyrjet e planifikuara mbulojnë nevoja të përparimit shkollor të nxënësve, mirëqenies psikologjike të tyre dhe të sjelljes. Ato mund të merren me nevoja të individëve të caktuar, por, në radhë parë, me nevojat e grupeve të komunitetit shkollor, si: të nxënësve, të mësuesve, të prindërve, të administratës shkollore, si edhe të lidhjeve me komunitetin jashtëshkollor. Planifikimi i ndërhyrjeve në plotësimin e nevojave nuk e përjashton, por përkundrazi, e nënkupton përfshirjen e kontributit me shërbime psikologjike të aktorëve jashtëshkollorë. Në këto raste, ato planifikohen në bashkëveprim me shkolla ose agjenci të tjera, për t'u ofruar në përshtatje me

planin.

Planifikimi i ndërhyrjeve synon zhvillimin e një procesi dhe arritjen e rezultateve të caktuara. Kjo kërkon që, kur planifikohet, të përcaktohen edhe rezultatet e pritshme.

Nënfushat përbërëse të *Planifikimit* janë:

- a) Njohuritë dhe zotësitë për planifikim,
- b) Praktika e planifikimit.

Nënfusha I: Njohuritë dhe zotësitë në planifikim

Nga psikologu shkollor pritet që ai të zotërojë njohuri dhe shkathtësi të caktuara për planifikim. Disa nga zotësitë kryesore të psikologut shkollor në këtë nënfushë janë: njohja dhe zotërimi i koncepteve bazike mbi planifikimin, fushat për të cilat bëhet planifikim, lidhja mes vlerësimit dhe planit të ndërhyrjes, grafiku i veprimtarive të planifikuara, planifikimi i ndërhyrjes individuale dhe në grup etj.

Nënfusha II: Praktika e planifikimit

Nga psikologu shkollor pritet që ai të përfshihet në punë reale planifikuese. Në këtë drejtim psikologu shkollor njeh rolin e vet si person që merret me planifikim ndërhyrjesh, zotëron shkathtësi bashkëpunimi me të tjerë në këtë proces, merr pjesë individualisht ose në grupe pune në nivel shkolle dhe DAR/ZA-je.

Nënfusha 1	Treguesit	Instrumentet Psikologu shkollor:	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
I. Njohuri dhe zotësi në	1. Psikologu shkollor	1.1.1. Ka njohuri për teoritë e ndërhyrjes psikologjike.				
		1.1.2. Argumenton konceptin që ka për planifikimin,				

planifikim	argumenton konceptet e tij kryesore mbi planifikimin, si një nga fushat e punës së tij në shkollë.	bazuar në eksperiencën e tij.				
		1.1.3. Vërteton se aktivitetet planifikuese ku është përfshirë, janë bazuar në vlerësimin e nevojave.				
		1.1.4. Tregon se zotëron njohuritë e nevojshme për kryerjen e procesit të planifikimit.				
		1.1.5. Siguron se ndërhyrjet e kryera janë bazuar në veprimtari të planifikuara.				
		1.1.6. Argumenton që ndërhyrjet e paplanifikuara kanë qenë të lidhura kryesisht me incidente kritike (kriza).				
		1.1.7. Përkrauan monitorimin që kryhet për procesin e planifikimit.				
		1.1.8. Siguron konsulencën e aktorëve të jashtëm (individë, organizata, prindër, organe drejtuese arsimore) në procesin planifikues.				
		1.1.9. Siguron që aktivitetet planifikuese të bëhen me përparësi për çështjet më të nxehta.				
		1.1.10. E kupton se ndërhyrjet e sakta duhet të marrin në konsideratë stadin e zhvillimit të nxënësit, stilin e tij të të nxënësit, si dhe pikat e forta e nevojat e tij.				
		1.1.11. Koordinon aktivitetet planifikuese në nivel shkolle me ato në nivel ZA-je dhe DAR-i.				
		2. Psikologu shkollor dëshmon zotërimin e koncepteve kryesore rreth planifikimit, si një nga fushat e	1.2.1. Liston aktivitetet planifikuese ku është përfshirë.			
1.2.2. Dëshmon të kuptuarit e planifikimit si proces i organizuar.						
1.2.3. Dëshmon që aktivitetet planifikuese kanë qenë të koordinuara.						
1.2.4. Dëshmon se aktivitetet planifikuese ku është përfshirë,						

punës së tij në shkollë.	janë kryer në grup.				
	1.2.5. Dëshmon se procesi i planifikimit është i orientuar drejt arritjes së rezultateve.				
	1.2.6. Dëshmon se planifikimi mbulon fushën e vlerësimit, konsultimit, këshillimit dhe të zhvillimit profesional të aktorëve.				
	1.2.7. Zotëron njohuri për modelet dhe metodat që sigurojnë informacionin e vlefshëm për identifikimin e pikave të forta dhe të nevojave për zbulimin e problemeve dhe për matjen e përparimit shkollor.				
	1.2.8. Vërteton lidhjen e raporteve të vlerësimit me punën planifikuese.				
	1.2.9. Vërteton lidhjen e rezultateve të vlerësimit me elemente të planit të ndërhyrjes.				
	1.2.10. Dëshmon se planifikimin e kryen në bashkëpunim me aktorë të tjerë.				
	1.2.11. Dëshmon se aktivitetet planifikuese mbulojnë me përparësi nevojat e grupeve dhe pastaj ato të individëve.				

Nënfusha 2	Treguesit	Instrumentet	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
	1. Psikologu shkollor kryen aktivitete të planifikimit të ndërhyrjeve në nivel shkolle e DAR/ZA-je, si	2.1.1. Vërteton pjesëmarrjen e tij në grupe pune për planifikimin e ndërhyrjeve.				
		2.1.2. Vërteton se të gjitha ndërhyrjet paraprihen nga veprimtari planifikuese.				
		2.1.3. Është pjesë e ekipit të shkollës që harton planin individual të edukimit për nxënësit me nevoja të veçanta dhe aftësi të kufizuara.				

pjesë e grupeve të punës për planifikimin e ndërhyrjeve.	2.1.4. Bashkëpunon me ekipin e mësuesve për të hartuar një program mësimor cilësor për çdo subjekt.				
	2.1.5. Shërben si pjesëtar i grupeve në shërbim të nxënësve (grupet e ndërhyrjes, grupet e zgjidhjes së problemit etj).				
	2.1.6. Identifikon dhe përdor teknika të parandalimit të dukurive të padëshirueshme.				
	2.1.7. Punon për përfshirjen e prindërve, mësuesve dhe të profesionistëve të tjerë, si anëtarë të ekipit të shkollës.				
	2.1.8. Pajis ekipet e ndërhyrjes në nivel shkolle me informacionin e nevojshëm për veprim.				
	2.1.9. Jep kontributin e tij në grupe pune për planifikimin e ndërhyrjeve në nivel DAR/ZA-je, në drejtim të: a) planifikimit të trajnimeve; b) ndërhyrjeve kurrikulare; c) fushatave sensibilizuese; d) aktiviteteve rekreative etj.				
	2.1.10. Grupet e ngritura për planifikimin, në bazë të vlerësimit të nevojave në grup të nxënësve, zbulojnë çështjet kryesore, për të cilat janë ngritur dhe hartojnë agjenda të ndërhyrjes qoftë në nivel shkolle, qoftë në nivel DAR/ZA-je.				
	2.1.11. Në bazë të vlerësimeve, propozon ndërhyrje konkrete.				
	2.1.12. Lidh gjetjet e vlerësimeve të kryera me veprimet për hartimin e ndërhyrjeve sa më efikase.				
	2.1.13. Dokumenton rolin e tij specifik në proceset planifikuese në grupet e punës.				
	2.1.14. Ilustron lidhjen e aktiviteteve të planifikuara me nevojat ekzistuese.				
2.1.15. Ilustron lidhjen e aktiviteteve të planifikuara me stadin zhvillimor dhe psikologjinë e subjektit.					

		2.1.16. Ndhomon në planifikimin dhe dhënien e shërbimeve me stafin profesional, në situatë krizash.				
		2.1.17. Bashkëpunon me agjenci të tjera në komunitet për ofrimin e shërbimeve të koordinuara, në situata krize.				
2. Psikologu shkollor kryen një sërë aktivitësh planifikuese.	2.2.1. Vërteton se aktiviteti planifikues përmban veprimtari të larmishme.					
	2.2.2. Tregon se aktiviteti planifikues përmban veprimtari shumëfunktionale.					
	2.2.3. Tregon se ndërhyrjet e planifikuara mbulojnë: a) nevoja të përparimit të nxënësve; b) mirëqenien e tyre psikologjike; c) nevoja të sjelljes.					
	2.2.4. Kryen aktivitete planifikuese për nevojat e individëve të caktuar, duke u dhënë më shumë përparësi nevojave në grup të komunitetit shkollor: a) nxënësve; b) mësuesve; c) prindërve; d) administratës shkollore; e) komunitetit jashtëshkollor.					
	2.2.5. Vërteton që aktivitetet planifikuese kanë përfunduar që në fillim të vitit shkollor.					
	2.2.6. Kryen aktivitete planifikuese që mbulojnë sensibilizimin, rehabilitimin, argëtimin etj. të tilla, si: a) aktivitete sensibilizuese; b) aktivitete polivalente kulturore-argëtuese; c) trajnime psiko-edukative					
	2.2.7. Asiston me ndërtimin dhe/ose trajnimin e stafit në përdorimin e praktikave parandaluese.					

		2.2.8. Identifikon burimet e shkollës dhe të komunitetit për mbështetjen e nxënësve dhe të familjeve.				
		2.2.9. Përdor teknikat e duhura për t'iu përgjigjur situatave kritike, kur është e nevojshme.				
		2.2.10. Demonstron aftësi në përdorimin e informacionit të vlerësimit, në dizenjimin dhe në zbatimin e programeve, që synojnë plotësimin e nevojave individuale.				
		2.2.11. Kontribuon në përgjigjen ndaj situatave ku ka krizë dhe praktika të tjera ndërhyrëse.				
		2.2.12. Kryen vlerësime për reagimin ndaj krizave dhe për efikasitetin e praktikave të ndërhyrjes, duke sugjeruar përmirësimet e nevojshme.				
		2.2.13. Dëshmon se aktivitetet e planifikuara përmbajnë elemente krijuese.				
		2.2.14. Veprimtaritë e planifikuara janë të përshtatura me psikologjinë/specifikat e individit dhe të grupit të targetuar.				
		2.2.15. Siguron se ndërhyrjet e planifikuara janë vlerësuar në proces dhe në përfundim të tyre.				
		2.2.16. Ofron mentorim për kolegët.				

STANDARDI

Shërbimet që ofrohen në shkolla bazohen në një planifikim strategjik, i cili bazohet në vlerësimin e nevojave dhe në çeljen e perspektivave të caktuara. Psikologët shkollorë përfshihen në proceset dhe në grupet që merren me planifikimin e ndërhyrjeve. Proceset planifikuese kanë karakter planifikues e trajtues. Kontributi i psikologut shkollor në planifikim shprehet, por nuk kufizohet në: pjesëmarrje në grupet e punës, diskutime dhe propozime ndërhyrjesh, raportim të gjetjeve të vlerësimeve, kryerjen e roleve specifike në proceset planifikuese, duke dokumentuar punën e kryer etj. Shembuj të këtij kontributi janë pjesëmarrjet në planifikimin e trajnimeve, të ndërhyrjeve kurrikulare, të fushatave sensibilizuese, të aktiviteteve rekreative etj.

Niveli 1

Psikologu shkollor pothuajse gjithmonë zotëron, shpreh, argumenton konceptet e tij bazike mbi planifikimin, si një nga fushat kryesore të punës së tij në shkollë.

Psikologu shkollor pothuajse gjithmonë zotëron dhe demonstroi përdorimin e një liste të larmishme shkathtësish, për të ofruar planifikime të frytshme për aktorët me të cilët bashkëpunon.

Psikologu shkollor pothuajse gjithmonë përfshihet dhe është pjesë e grupeve të punës në planifikime. Roli i tij në këto grupe është shumë aktiv dhe shumë profesional.

Psikologu shkollor pothuajse gjithmonë kryen aktivitete planifikuese. Pothuajse gjithmonë, ai kujdeset që veprimtaria e vet të jetë e planifikuar dhe e dokumentuar.

Niveli 2

Psikologu shkollor herë pas here zotëron, shpreh, argumenton konceptet e tij bazike mbi planifikimin, si një nga fushat kryesore të punës së tij në shkollë. Psikologu shkollor herë pas here zotëron dhe demonstroi përdorimin e një liste të larmishme shkathtësish, për të ofruar planifikime të frytshme për aktorët me të cilët bashkëpunon. Psikologu shkollor herë pas here përfshihet dhe është pjesë e grupeve të punës në planifikime. Roli i tij në këto grupe është aktiv dhe profesional. Psikologu shkollor herë pas here kryen aktivitete planifikuese. Herë pas here, ai kujdeset që veprimtaria e vet të jetë e planifikuar dhe e dokumentuar.

Niveli 3

Psikologu shkollor nganjëherë zotëron, shpreh, argumenton konceptet e tij bazike mbi planifikimin, si një nga fushat kryesore të punës së tij në shkollë. Psikologu shkollor nganjëherë zotëron dhe demonstroi përdorimin e një liste të larmishme shkathtësish, për të ofruar planifikime të frytshme për aktorët me të cilët bashkëpunon. Psikologu shkollor nganjëherë përfshihet dhe është pjesë e grupeve të punës në planifikime. Roli i tij në këto grupe është pasiv dhe jo shumë profesional. Psikologu shkollor nganjëherë kryen aktivitete planifikuese. Nganjëherë kujdeset që veprimtaria e tij të jetë e planifikuar dhe e dokumentuar.

Niveli 4

Psikologu shkollor rrallëherë zotëron, shpreh, argumenton konceptet e tij bazike mbi planifikimin, si një nga fushat kryesore të punës së tij në shkollë. Psikologu shkollor rrallëherë zotëron dhe demonstroi përdorimin e një liste të larmishme shkathtësish, për të ofruar planifikime të frytshme për aktorët me të cilët bashkëpunon. Psikologu shkollor rrallëherë përfshihet dhe është pjesë e grupeve të punës

në planifikime. Roli i tij në këto grupe është pasiv dhe jo profesional. Psikologu shkollor rrallëherë kryen aktivitete planifikuese. Rrallëherë kujdeset që veprimtaria e tij të jetë e planifikuar dhe e dokumentuar.

Fusha III: KONSULTIMI DHE BASHKËPUNIMI

Psikologu shkollor nuk punon i izoluar nga aktorët e tjerë që veprojnë në shkollë dhe në komunitetin e saj më të afërt. Ai përfshihet në veprimtari konsultative dhe bashkëpunon në mënyrë efektive me të tjerët në të gjitha fazat e procesit: në vlerësim, planifikim, trajtim në nivel individual, grupi dhe sistemi.

Konsultimi kuptohet në mënyra të ndryshme. Përgjithësisht, ai shihet si shkëmbim mendimesh, por nuk mungojnë rastet kur kuptohet si mënyrë për të sugjeruar interpretime e veprime të caktuara. Në fakt, konsultimi i përfshin këto aktivitete dhe shtrihet përtej tyre; ai ka të bëjë me përfshirjen në zgjidhjen e problemeve që dalin. Në këto procese ndodh edhe shkëmbimi i mendimeve, edhe rekomandimi, edhe mbështetja, edhe nxitja, edhe frenimi, edhe përhapja e informacionit.

Psikologët shkollorë kanë formimin e duhur për të ofruar konsultime për të gjithë aktorët e lidhur me nxënësit: mësuesit, nxënësit, prindërit, administratën dhe agjencitë bashkëpunuese. Konsultimi mbulon çështjet e përparimit shkollor, të sjelljes dhe të mirëqenies psikologjike. Psikologët shkollorë, të përfshirë në ofrimin e shërbimit psikologjik, janë të interesuar për këndvështrimet e të gjithë aktorëve.

Psikologët shkollorë konsultohen me aktorët e tjerë, falë zotërimit të shkathtësive ndërpersonale, sidomos të atyre komunikative. Aftësitë për të ndërtuar komunikime të frytshme me aktorë të interesuar e të painteresuar, të motivuar e të pamotivuar, mikpritës e të distancuar etj., u mundësojnë psikologëve kryerjen e konsultimeve të frytshme.

Konsultimi na jep mundësinë që të realizojmë një analizë të nevojave (analizën e nevojave e realizon procedura e vlerësimit, ndërsa konsultimi mund të përdoret për ta bërë këtë analizë) për të nxjerrë në pah problematikat që ndeshen rëndom në brendësi të shkollës dhe në rrjetin e shkollave. Në këtë mënyrë, këto problematika mund të sillen dhe të merren në konsideratë për t'u trajtuar në projekte specifike. Është tepër frytdhënëse nxjerrja e tematikave domethënëse nga terreni. Po kështu, është e nevojshme që psikologu të jetë pjesëmarrës aktiv në realizimin e projekteve të ndryshme, që realizon shkolla dhe madje, të jetë edhe vetë iniciator i këtyre projekteve ndërhyrëse, nëpërmjet konsultimit me aktorë të tjerë të rëndësishëm, si: drejtorë, mësues, prindër, nxënës, struktura të tjera qeveritare dhe joqeveritare.

Psikologët shkollorë janë të interesuar jo vetëm për të pasur lidhje me aktorët e tjerë, por edhe për kontributin e tyre. Ata i ofrojnë konsultimet në një klimë bashkëpunimi me aktorët, brenda së cilës planifikojnë, caktojnë përparësi, “ndajnë rolet”, negociojnë dhe marrin vendime në nivel individual, në grup apo në nivel sistemi. Bashkëpunimi përbën një fushë të punës së psikologëve shkollorë dhe

nënkupton moslejimin për të vepruar të izoluar brenda një sistemi kompleks nga pikëpamja e aktorëve, e marrëdhënieve, e veprimtarive e karakteristikave.

Roli i ri i psikologut shkollor kërkon bashkëpunimin e tij me aktorët e tjerë. Nëse çdo mësues ka “lëndën e vet”, psikologu shkollor është një profesion që i kërkon atij të bashkëpunojë me të gjithë aktorët e tjerë. Në këtë proces ndihmojnë shkathtësi të tilla, si ato ndërpersonale: aftësia për të ndërtuar dhe për të zhvilluar marrëdhënie, aftësitë për ta mbajtur bashkëpunimin frytdhënës, aftësitë për të dëgjuar dhe respektuar, aftësitë për të vlerësuar kontributet etj. Psikologët shkollorë, jo vetëm që nuk mund të ofrojnë shërbimet e tyre pa bashkëpunuar, por ata nuk mund të mos ndërhyjnë, kur shohin se bashkëpunimi aq i kërkuar i shkollës me familjen nuk është në lartësinë e duhur. Është një nga detyrat e psikologut shkollor të punojë për forcimin e këtij bashkëpunimi që kërkohet tradicionalisht, por që herë-herë nuk është aq i kënaqshëm.

Nënfushat përbërëse të *Konsultimit dhe të bashkëpunimit* janë:

- a) Njohuri për konsultimin,
- b) Praktika e konsultimit,
- c) Njohuri për bashkëpunimin,
- d) Praktika e bashkëpunimit.

Nënfusha I: Njohuritë për konsultimin

Njohuritë për konsultimin përbëjnë një nga nënfushat e tij. Kompetencat e psikologut shkollor në këtë nënfushë përfshijnë, por nuk kufizohen në: zotërimin e koncepteve të qarta për konsultimin, njohjen e dobisë së punës konsultuese, prezencën e besimeve pozitive në lidhje me potencialin e konsultimeve.

Nënfusha II: Praktika e konsultimit

Praktika e konsultimit është nënfusha që mund të dëshmojë praktikën psikologjike konsultuese. Kompetencat e psikologut shkollor në këtë nënfushë përfshijnë, por nuk kufizohen në shkathtësitë për konsultim dhe përfshirjen në veprimtaritë konsultuese. Nga psikologu shkollor pritet që ai të përfshihet në një praktikë të zgjeruar konsultimesh me të gjithë aktorët shkollorë, si edhe në veprimtari të shumëllojshme konsultuese.

Nënfusha III: Njohuritë për bashkëpunimin

Nga psikologu shkollor pritet që ai të zotërojë njohuri mbi bashkëpunimin; të dijë se si bashkëpunohet me persona të tjerë. Kompetencat e psikologut shkollor në këtë nënfushë përfshijnë, por nuk kufizohen në: zotërimin e koncepteve të qarta për bashkëpunimin, njohjen e dobisë së bashkëpunimit, prezencën e besimeve pozitive në lidhje me potencialin e bashkëpunimit.

Nënfusha IV: Praktika e bashkëpunimit

Nga psikologu shkollor priten bashkëpunime reale. Ai duhet të ketë bashkëpunëtorët e vet, filozofinë përkatëse të bashkëpunimit me ta dhe të dëshmojë praktikën psikologjike bashkëpunuese të punës në këtë proces. Kompetencat e psikologut shkollor në këtë nënfushë përfshijnë, por nuk kufizohen në shkathtësitë për bashkëpunim dhe përfshirjen në veprimtari, të cilat kryhen vetëm në bashkëpunim me aktorë të tjerë.

Nënfusha 1	Treguesit	Instrumentet Psikologu shkollor:	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
Njohuri për konsultimin	1. Psikologu shkollor zotëron konceptet kryesore mbi konsultimin, si një nga fushat e punës së tij në shkollë.	1.1.1. E sheh konsultimin si proces të njohjes së këndvështrimeve të të tjerëve për një çështje.				
		1.1.2. E sheh konsultimin si proces të përfshirjes në zgjidhjen e problemeve.				
		1.1.3. Argumenton rëndësinë që ka procesi i konsultimit në punën e psikologut shkollor.				
		1.1.4. E sheh konsultimin si mjet për qartësimin e aktorëve të tjerë të përfshirë në çështje (problem).				
		1.1.5. Mbështetet tek konsultimi, para se të ndërmarrë një nismë në shkollë.				
		1.1.6. Njeh mangësitë që ka puna psikologjike e izoluar.				
		1.1.7. Nxit frymën e konsultimit në institucion, tek mësuesit, nxënësit, drejtuesit, prindërit.				
		1.1.8. Shpreh besim për rëndësinë e procesit të konsultimit në të gjitha operacionet e procesit, si: në vlerësim, planifikim, trajtim.				
		1.1.9. Shpreh besim për rëndësinë e procesit të konsultimit në nivel individit, grupi dhe sistemi.				

Nënfusha 2	Treguesit	Instrumentet	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
Praktika e konsultimit	1. Psikologu shkollor zotëron shkathhtësi për të ofruar konsultime të frytshme për					
		2.1.1. Konsultohet me individët e duhur për çështjet me të cilat merret.				
		2.1.2. Respekton mendimet e aktorëve të tjerë, duke nxitur				

aktorët me të cilët bashkëpunon.	diversitetin në mënyrën e zgjidhjes së problemeve.				
	2.1.3. Prirjet të veprojë, vetëm pasi i ka zhvilluar të gjitha konsultimet e nevojshme.				
	2.1.4. Ruan marrëdhënie me aktorët e konsultimeve gjatë gjithë kohës së aplikimit të një projekti konkret.				
	2.1.5. Zotëron shkathhtësitë e nevojshme të komunikimit (dëgjimit, mbështetjes, empatisë etj.).				
	2.1.6. Demonstron zotësi për ndërtimin dhe zhvillimin e marrëdhënieve.				
	2.1.7. Prirjet (synon) që konsultimi t'i çojë çështjet përpara.				
	2.1.8. Gëzon reputacionin e njeriut të gatshëm për të bërë konsultime.				
	2.1.9. Përdor takt në marrëdhëniet njerëzore, me qëllim që të shmangët refuzimi i ideve të kundërta, të dhëna nga të tjerët.				
	2.1.10. Përqendrohet në thelbin e pikëpamjeve të personave me të cilët konsultohet.				
	2.1.11. Orientohet drejt elementeve më pozitive të pikëpamjeve të personave me të cilët konsultohet.				
	2.1.12. Zotëron aftësinë e shmangies së kritikës gjatë konsultimit.				
	2. Psikologu shkollor përfshihet në veprimtari konsultuese me aktorët shkollorë e jashtëshkollorë, për çështjet mësimore,	2.2.1. Konsultohet rregullisht për çështjet e përparimit shkollor, me mësues, drejtorin, nxënës, prindër, administratën e shkollës, senatin.			
2.2.2. Konsultohet rregullisht për çështjet e funksionimit individual e social.					
2.2.3. Konsultohet rregullisht me prindërit për çështjet e stileve të prindërimit dhe të marrëdhënieve prind–fëmijë.					

zhvillimore dhe të mirëqenies psikologjike.	2.2.4. Konsultohet dhe informon mësuesit për aspektet psikologjike që lidhen me zhvillimin e nxënësve.				
	2.2.5. Konsultohet me mësuesit, organet kolegjiale dhe drejtorin e institucionit për problematikat e tipave psikologjikë, marrëdhëniet njerëzore, zhvillimin e veprimtarive didaktike dhe të formimit.				
	2.2.6. Ofron konsultime për nxënës (individë e grupe) sipas kërkesës së tyre.				
	2.2.7. Konsultohet rregullisht për çështjet e sjelljes, me nxënës, mësues, prindër, komunitet.				
	2.2.8. Ofron konsultime për prindër që bëjnë kërkesë, në lidhje me temat e zhvillimit të fëmijëve dhe të marrëdhënieve të tyre jetësore.				
	2.2.9. Konsultohet me të gjithë aktorët përkatës pa dallim: nxënës, mësues, prindër, persona e agjenci komunitare.				
	2.2.10. Ofron konsultime për mësuesit në lidhje me procesin e të nxënës dhe dinamikat e grupit të klasës, në lidhje me stilet individuale të të mësuarit.				
	2.2.11. Ofron konsultime me organet kolegjiale, drejtuesit e shkollës, komisionet dhe grupet e punës, në lidhje me gjithçka që ka të bëjë me përparimin dhe aktivizimin e projekteve specifike.				

Nënfusha 3	Treguesit	Instrumentet	Nivelet e vlerësimit			
Njohuri për bashkëpunim in	1. Psikologu shkollor argumenton konceptet e tij	3.1.1. E sheh bashkëpunimin si proces të marrjes së mendimit të aktorëve të tjerë.	1	2	3	4
		3.1.2. E sheh bashkëpunimin si rrugë për të thithur kontributin e aktorëve të tjerë.				

<p>kryesore për bashkëpunimin, si një nga fushat e punës së tij në shkollë.</p>	<p>3.1.3. E njeh bashkëpunimin si metodë efikase për të arritur rezultate të dukshme në veprimtaritë që ndërmerr në shkollë.</p>				
	<p>3.1.4. Pranon mangësitë e punës psikologjike që nuk mbështetet në bashkëpunimin me persona e agjenci të tjera.</p>				
	<p>3.1.5. Synon të përfshijë sa më shumë aktorë dhe të bëjë një ndarje objektive të rolit dhe të punës së gjithsecilit.</p>				
	<p>3.1.6. Dëshmon zotësi në ndarjen e detyrave mes personave a palëve që bashkëpunojnë.</p>				
	<p>3.1.7. U jep bashkëpunëtorëve gjithë informacionin e nevojshëm për bashkëpunim efektiv.</p>				
	<p>3.1.8. Nxit frymën e kohezionit brenda grupit të punës përmes optimizmit që përcjell dhe modelit të zotërimit të shprehive të vlerave njerëzore.</p>				
	<p>3.1.9. Dëshmon zotësi në ruajtjen e motivacionit të bashkëpunëtorëve.</p>				
	<p>3.1.10. Tregon besim mbi rëndësinë e procesit të bashkëpunimit në të gjitha operacionet e tij, si: në vlerësim, planifikim, trajtim.</p>				
	<p>3.1.11. Tregon besim mbi rëndësinë e procesit të bashkëpunimit në nivel individ, grupi dhe sistemi.</p>				
	<p>3.1.12. Dëshmon se bashkëpunëtorët e tij janë gjithmonë drejtoria e shkollës, prindërit, nxënësit, agjencitë komunitare.</p>				

Nënfusha 4	Treguesit	Instrumentet	Nivelet e vlerësimit			
Praktika e bashkëpunimit	1. Psikologu shkollor zotëron një larmi shkathtësish për të ndërtuar, për të ruajtur dhe për të zhvilluar bashkëpunime sa më të frytshme institucionale.	4.1.1. Bashkëpunon me individët e duhur për çështjet me të cilat merret.	1	2	3	4
		4.1.2. Priret të veprojë, pasi ka siguruar të gjithë bashkëpunëtorët e nevojshëm.				
		4.1.3. Demonstron zotësi për ndërtimin dhe zhvillimin e marrëdhënieve bashkëpunuese.				
		4.1.4. Monitoron kontributin që vjen nga bashkëpunëtorët.				
		4.1.5. Vlerëson kontributin e secilit aktor të përfshirë në projekt, duke nxjerrë në pah vlerat.				
		4.1.6. Nxit dhe vlerëson para grupit aftësitë bashkëpunuese të aktorëve.				
		4.1.7. Angazhohet maksimalisht në bashkëpunimet brenda institucionit dhe në përfshirjen e prindërve e agjencive komunitare.				
		4.1.8. Priret që të vlerësojë kontributet e bashkëpunëtorëve.				
		4.1.9. Dëshmon zotësi për të gjykuar për bashkëpunimet që ka.				
		4.1.10. Gëzon reputacionin e njeriut të prirur drejt bashkëpunimit.				
		4.1.11. Promovon nismat e bashkëpunimit dhe jep modele për t'u marrë shembull nga nxënësit dhe trupa pedagogjike.				
		4.1.12. Tregon hapat që ka ndërmarrë në bashkëpunimin me të tjerët.				
		4.1.13 . Disponon materiale dhe lista që përcaktojnë rolin dhe angazhimin e aktorëve të tjerë kontribuues.				
	2. Psikologu shkollor përfshihet	4.2.1. Tregon bashkëpunëtorët e tij më të afërt dhe më të shpeshtë.				

<p>në bashkëpunime me aktorët shkollorë e jashtëshkollorë për çështjet mësimore, zhvillimore dhe të mirëqenies së aktorëve shkollorë.</p>	<p>4.2.2. Dëshmon veprimtari të kryera në bashkëpunim.</p>				
	<p>4.2.3. Tregon bashkëpunimet brenda dhe jashtë sistemit shkollor.</p>				
	<p>4.2.4. Bashkëpunon me organet kolegjiale të shkollës, në lidhje me programin dhe zbatimin e projekteve specifike të ndërhyrjes parandaluese dhe trajtuese.</p>				
	<p>4.2.5. Siguron bashkëpunëtorët më të aftë për orientimin profesional të nxënësve.</p>				
	<p>4.2.6. Bashkëpunon me mësues, prindër, nxënës, institucione për ndërhyrje që lidhen me komponentët psikologjikë të veprimtarive edukative dhe të vështirësive shkollore.</p>				
	<p>4.2.7. Bashkëpunon me qendrat e zhvillimit në terren, në lidhje me mundësitë e përfshirjes së nxënësve me nevoja të veçanta në plane rehabilitimi.</p>				
	<p>4.2.8. Mban kontakte të rregullta me bashkëpunëtorët komunitarë jashtëshkollorë.</p>				
	<p>4.2.9. Bashkëpunon për informimin e prindërve dhe lehtësimin e kontakteve dhe të mundësive për shfrytëzimin e shërbimeve rehabilituese.</p>				
	<p>4.2.10. Bashkëpunon me mësues, prindër, profesionistë të jashtëm në programimin e iniciativave për veprimtari edukative të individualizuara për nxënës me nevoja të veçanta</p>				
	<p>4.2.11. Bashkëpunon me stafin për aspektet psikologjike të veprimtarive edukative të klasave dhe të shkollës në përgjithësi.</p>				
	<p>4.2.12. Bashkëpunon me drejtuesit shkollorë për aktivitetet e kërkimit shkencor që organizohen në shkollë nga stafi i</p>				

		saj, nga agjenci ose persona të jashtëm.				
		4.2.13. Bashkëpunon me mësuesit për kuptimin e proceseve psikologjike me ndikim në mësimdhënie dhe në të nxënë.				
		4.2.14. Bashkëpunon me mësuesit për përshtatjen e kurrikulës me proceset dhe kapacitetet psikologjike të nxënësve.				
		4.2.15. Bashkëpunon me mësuesit për ndërhyrje që lidhen me fenomenet e vështirësive shkollore dhe për hartimin e planeve individuale të studimit.				
		4.2.16. Bashkëpunon me mësues, prindër, nxënës dhe institucione të tjera për organizimin e veprimtarive, që synojnë sensibilizimin e komunitetit mbi probleme apo nisma humanitare.				
		4.2.17. Bashkëpunon me personat dhe palët përkatëse për organizimin e ceremonive rutinore dhe të ngjarjeve të posaçme të shkollës.				

STANDARDI

Psikologët shkollorë kanë formimin e duhur për të ofruar konsultime për të gjithë aktorët e lidhur me nxënësit: mësuesit, nxënësit, prindërit, administratën dhe agjencitë bashkëpunuese. Konsultimi është procesi i shkëmbimit të të dhënave, perceptimeve dhe i mendimeve mes këtyre aktorëve dhe mbulon çështjet e përparimit shkollor, të sjelljes, të mirëqenies psikologjike etj. Psikologët shkollorë, të përfshirë në ofrimin e shërbimit psikologjik, janë të interesuar për këndvështrimet e të gjithë aktorëve. Ata i ofrojnë këto konsultime në një klimë bashkëpunimi me këta aktorë, brenda së cilës ata planifikojnë, caktojnë përparësi, ndajnë rolet, negociojnë dhe marrin vendime në nivel individual, në grup apo në sistem.

Niveli 1

Psikologu shkollor pothuajse gjithmonë zotëron, shpreh, argumenton konceptet e tij bazike mbi konsultimin, si një nga fushat e punës së tij në shkollë. Psikologu shkollor pothuajse gjithmonë zotëron dhe demonstroi përdorimin e një larmie shkathtësish, për të ofruar konsultime të frytshme për aktorët me të cilët bashkëpunon. Psikologu shkollor pothuajse gjithmonë përfshihet në veprimtari konsultuese me aktorët shkollorë e jashtëshkollorë, për çështjet mësimore, zhvillimore dhe të mirëqenies së aktorëve shkollorë dhe të proceseve që organizohen për ta. Psikologu shkollor pothuajse gjithmonë zotëron, shpreh, argumenton konceptet e tij bazike mbi bashkëpunimin, si një nga fushat e punës së tij në shkollë. Psikologu shkollor pothuajse gjithmonë zotëron dhe demonstroi një larmi shkathtësish për të ndërtuar, për të ruajtur dhe për të zhvilluar bashkëpunime sa më të frytshme për aktorët, me të cilët bashkëpunon, dhe gjithë institucionin.

Psikologu shkollor pothuajse gjithmonë përfshihet në bashkëpunime me aktorët shkollorë e jashtëshkollorë për çështjet mësimore, zhvillimore e të mirëqenies së aktorëve shkollorë, si dhe të proceseve që organizohen për ta.

Niveli 2

Psikologu shkollor herë pas here zotëron, shpreh, argumenton konceptet e tij bazike mbi konsultimin, si një nga fushat e punës së tij në shkollë. Psikologu shkollor herë pas here zotëron dhe demonstroi përdorimin e një larmie shkathtësish, për të ofruar konsultime të frytshme për aktorët me të cilët bashkëpunon. Psikologu shkollor herë pas here përfshihet në veprimtari konsultuese me aktorët shkollorë e jashtëshkollorë, për çështjet mësimore, zhvillimore dhe të mirëqenies së aktorëve shkollorë dhe të proceseve që organizohen për ta.

Psikologu shkollor herë pas here zotëron, shpreh, argumenton konceptet e tij bazike mbi bashkëpunimin, si një nga fushat e punës së tij në shkollë. Psikologu shkollor herë pas here zotëron dhe demonstroi një larmi shkathtësish për të ndërtuar, për të ruajtur dhe për të zhvilluar bashkëpunime sa më të frytshme për aktorët, me të cilët bashkëpunon, dhe gjithë institucionin.

Psikologu shkollor herë pas here përfshihet në bashkëpunime me aktorët shkollorë e jashtëshkollorë për çështjet mësimore, zhvillimore e të mirëqenies së aktorëve shkollorë, si dhe të proceseve që organizohen për ta.

Niveli 3

Psikologu shkollor nganjëherë zotëron, shpreh, argumenton konceptet e tij bazike mbi konsultimin, si një nga fushat e punës së tij në shkollë. Psikologu shkollor nganjëherë zotëron dhe demonstroi përdorimin e një larmie shkathtësish, për të ofruar konsultime të frytshme për aktorët me të cilët bashkëpunon. Psikologu shkollor nganjëherë përfshihet në veprimtari konsultuese me aktorët shkollorë e jashtëshkollorë për çështjet mësimore, zhvillimore dhe të mirëqenies së aktorëve shkollorë dhe të proceseve që organizohen për ta.

Psikologu shkollor nganjëherë zotëron, shpreh, argumenton konceptet e tij bazike mbi bashkëpunimin, si një nga fushat e punës së tij në shkollë. Psikologu shkollor nganjëherë zotëron dhe demonstroi një larmi shkathtësish për të ndërtuar, për të ruajtur dhe për të zhvilluar bashkëpunime sa më të frytshme për aktorët, me të cilët bashkëpunon, dhe gjithë institucionin. Psikologu shkollor nganjëherë përfshihet në bashkëpunime me aktorët shkollorë e jashtëshkollorë, për çështjet mësimore, zhvillimore e të mirëqenies së aktorëve shkollorë, si dhe të proceseve që organizohen për ta.

Niveli 4

Psikologu shkollor nuk zotëron, nuk shpreh, nuk argumenton dot, pothuajse asnjëherë, konceptet e tij bazike mbi konsultimin, si një nga fushat e punës së tij në shkollë. Psikologu shkollor nuk zotëron dhe nuk demonstroi dot, pothuajse asnjëherë, përdorimin e një larmie shkathtësish, për të ofruar konsultime të frytshme për aktorët me të cilët bashkëpunon. Psikologu shkollor nuk përfshihet pothuajse asnjëherë në veprimtari konsultuese me aktorët shkollorë e jashtëshkollorë, për çështjet mësimore, zhvillimore dhe të mirëqenies së aktorëve shkollorë dhe të proceseve që organizohen për ta. Psikologu shkollor nuk zotëron, nuk shpreh, nuk argumenton pothuajse asnjëherë konceptet e tij bazike mbi bashkëpunimin, si një nga fushat e punës së tij në shkollë. Psikologu shkollor nuk zotëron dhe nuk demonstroi pothuajse asnjëherë një larmi shkathtësish për të ndërtuar, për të ruajtur dhe për të zhvilluar bashkëpunime sa më të frytshme për aktorët me të cilët bashkëpunon, si dhe me gjithë institucionin. Psikologu shkollor nuk përfshihet pothuajse fare në bashkëpunime me aktorët shkollorë e jashtëshkollorë, për çështjet mësimore, zhvillimore e të mirëqenies së aktorëve shkollorë, si dhe të proceseve që organizohen për ta.

Fusha IV: KËSHILLIMI

Shkollimi përfaqëson një investim të rëndësishëm për përparimin akademik, për zhvillimin social e emocional të fëmijëve dhe të adoleshentëve. Në kuptimin më të gjerë të saj, përpjekja që ky investim të japë frytet e tij në këto drejtime, ka të bëjë ndër të tjera, edhe me ndihmën që fëmijët dhe adoleshentët të përfitojnë sa më shumë prej këtij investimi. Këshillimi përfaqëson procesin me të cilin psikologët shkollorë ndihmojnë nxënësit të përfitojnë sa më shumë nga investimi arsimor dhe mundësitë që krijohen prej tij. Këshillimi është shërbimi që ofrohet për personat që kanë vështirësi të përballen me ato eksperiencat të jetës, të cilat pengojnë realizimin e plotë të potencialit të tyre.

Këshillimi ofrohet për individët dhe grupet dhe nuk përjashton aktorët e procesit: nxënësit, prindërit, mësuesit, administratën dhe grupet komunitare. Këshillimi shkollor synon shfrytëzimin e mundësive, optimizimin e përpjekjeve për ndryshim, kapërcimin e blokazhit, mbështetjen e ndryshimit, nxitjen dhe motivimin për ndryshim në fushën mësimore akademike, të marrëdhënieve sociale, të funksionimit personal.

Në rolin e këshilluesve, psikologët shkollorë merren me trajtimin e rasteve individuale dhe në grup. Këshillimi individual ofrohet në formën e takimeve individuale konfidenciale. Ai mbulon çështjet e mirëqenies psikologjike kryesisht të nxënësve, çështjet e vështirësive të tyre në përparimin në mësim, këshillimin e mësuesve për trajtimin e nxënësve me nevoja të caktuara, këshillimin e prindërve për trajtimin e fëmijëve dhe të adoleshentëve. Këshillimi në grup ofrohet në formën e punës në grup me natyrë sensibilizuese, informuese, trajnuese, mbështetëse. Forma më e shpeshtë e këshillimit në grup është trajnimi.

Gjendja e sotme e punëve në shkollë dhe niveli i përgatitjes profesionale të psikologëve shqiptarë kërkojnë që në raportin midis këshillimit individual dhe këshillimit me grupe, përparësi t'i jepet këshillimit me grupe. Kjo përparësi nuk e përjashton këshillimin individual, por nënvizon kërkesën që këshillimi në grup të zërë më shumë kohë në krahasim me këshillimin individual. Ai vazhdon të mbetet një shërbim që ofrohet për ata që e kërkojnë vullnetarisht, është konfidencial, i limituar në kohëzgjatje dhe merret pas referimit ose lejes së prindërve.

Puna këshilluese mbulon gjithashtu edhe ndërhyrjen në kriza dhe në incidente kritike. Në këto ndërhyrje, puna e psikologut shkollor konsiston në: ndihmën për formimin e ekipeve të përballimit të krizave, dhënien e ndihmës së parë psikologjike, identifikimin e personave që kanë nevojë për referim, informimin për ekzistencën e burimeve shtesë, koordinimin e ndihmës së jashtme për kapërcimin e krizës shkollore etj.

Psikologu shkollor shqiptar ka një formim të përgjithshëm; ai është përgatitur për t'u marrë me gjithë gamën e problematikës psikologjike shkollore, ndërsa trajtimin e specializuar, të cilin psikologu shkollor nuk është në gjendje dhe nuk e ka për detyrë ta ofrojë, ai e rekomandon të merret në agjencitë komunitare.

Në rolet e këshilluesit individual dhe të trajnerit në grup, psikologu shkollor ka nevojë për shkathtësi komunikative, të ndërtimit dhe administrimit të marrëdhënieve, të empatisë, të sfidimit, të motivimit, të sensibilizimit dhe të mbështetjes.

Nënfushat përbërëse të *Këshillimit* janë:

- a) Njohuri për këshillimin,
- b) Praktika e këshillimit.

Nënfusha I: Njohuritë për këshillimin

Nga psikologu shkollor pritet që ai të zotërojë njohuritë përkatëse për të ofruar këshillim për mësuesit, nxënësit, prindërit etj. Njohuritë për këshillimin përbëjnë njërin nga nënfushat e këshillimit. Kompetencat e psikologut shkollor në këtë nënfushë përfshijnë, por nuk kufizohen në: zotërimin e koncepteve të qarta për këshillimin, njohjen e fushëveprimit të punës këshilluese, njohjen e limiteve të këshillimit, besimin në potencialin e këshillimit si në formën individuale, ashtu edhe atë në grup.

Nënfusha II: Praktika e këshillimit

Nga psikologu shkollor pritet që të jetë përfshirë në një praktikë të gjerë këshilluese. Ai duhet të dëshmojë praktikën e këshillimit, në të cilën është i përfshirë. Kompetencat e psikologut shkollor në këtë nënfushë përfshijnë, por nuk kufizohen në: shkathtësitë specifike për këshillim, përfshirjen në veprimtari të larmishme këshilluese, si dhe në zotërimin e një etike të përparuar këshilluese.

Nënfusha 1	Treguesit	Instrumentet	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
Njohuri për këshillimin	1. Psikologu shkollor argumenton konceptet e tij për thelbin dhe kufizimet e këshillimit, si një nga fushat e punës së tij në shkollë.	Psikologu shkollor:				
		1.1.1. Koncepton këshillimin si procesin, me të cilin psikologët shkollorë ndihmojnë palët të përfitojnë sa më shumë nga investimi arsimor.				
		1.1.2. Koncepton këshillimin si marrëdhënie ndihme, që lëviz nga analiza e problemit të nxënësit në ndërtimin e një vizioni të ri.				
		1.1.3. Koncepton këshillimin si një plan veprimi për të arritur objektivat e dëshiruar nga klienti.				
		1.1.4. Koncepton këshillimin si veprimtari për të zhvilluar këndvështrime e sjellje të reja dhe funksionale të çështjeve.				
		1.1.5. Njeh karakterin aplikativ të këshillimit shkollor, si: shfrytëzimi i të gjitha mundësive, optimizimi i përpjekjeve për ndryshim, mbështetja e ndryshimit, nxitja dhe motivimi për ndryshim.				
		1.1.6. Aplikon këshillimin sipas qasjes sistemore, pa u ngushtuar në hallka të veçanta të tij.				
		1.1.7. Përqendron këshillimin e tij në fushën akademike, të marrëdhënieve sociale dhe të mirëqenies personale.				
		1.1.8. Argumenton rëndësinë që ka procesi i këshillimit në institucionin shkollor.				
		1.1.9. Tregon besim në rëndësinë e procesit të këshillimit si për trajtimin individual, ashtu edhe për atë në grup.				
		1.1.10. Koncepton këshillimin si proces ku individi përfshihet vullnetarisht.				
1.1.11. Zotëron shkathtësitë e hyrjes me lehtësi në						

		komunikim me persona që nuk i njeh.				
--	--	-------------------------------------	--	--	--	--

Nënfusha 2	Treguesit	Instrumentet	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
		2.1.1. Dëshmon aftësinë për dallimin e një marrëdhënieje profesionale nga një marrëdhënie personale.				
		2.1.2. Dëshmon aftësinë për dëgjimin aktiv të folësit.				
		2.1.3. Është i aftë të kuptojë bashkëbiseduesin, ashtu si e kupton ai veten e vet.				
		2.1.4. Dëshmon zotësinë për të depërtuar përtej asaj që bashkëbiseduesi thotë me fjalë.				
		2.1.5. Zotëron shkathtësitë e nevojshme për të ofruar mbështetje dhe sfidë.				
		2.1.6. Zotëron aftësinë për të zbuluar mundësitë e pashfrytëzuara të klientit (nxënësit).				
		2.1.7. Zotëron shprehi për sensibilizim e ndërgjegjësim të klientit (nxënësit) dhe grupit.				
		2.1.8. Zotëron shprehi për të motivuar klientin (nxënësin) dhe grupin.				
		2.1.9. Zotëron shprehi për të referuar klientët në mënyrë të përligjur.				
		2.1.10. Zotëron shprehinë e përshtatjes së këshillimit me situatën e krizës shkollore.				
		2.1.11. Zotëron aftësinë për t'ia përshtatur ndërhyrjen psikologjike urgjencës, përmasave dhe shkallës së traumës së pësuar.				

		2.1.12. Orientohet lehtë për të dhënë ndihmën e parë psikologjike për problematikat e lindura nga krizat shkollore.				
		2.1.13. Koordinon ndihmën e parë psikologjike dhe këshillimin që ofrojnë agjencitë komunitare në shkollë.				
		2.1.14. Posedon mënyra kontakti me agjenci dhe persona, për të kryer referime për trajtim të specializuar.				
		2.1.15. Zotëron aftësitë për të ndërtuar ndërhyrje në grup nëpërmjet trajnimeve.				
		2.1.16. Zotëron shkathtësitë specifike për të ofruar trajnime për përgatitje, për hartim të programit, për ofrimin e tij, për vlerësimin e efekteve të trajnimeve të ofruara.				
		2.1.17. Balancon këshillimin individual me atë në grup, duke ruajtur përparësinë e këshillimit në grup.				
	2. Psikologu shkollor përfshihet në veprimtari këshilluese individuale e në grup për aktorët shkollorë e jashtëshkollorë.	2.2.1. Dokumenton përfshirjen e tij në seancat e këshillimit individuale dhe në grup.				
		2.2.2. Është anëtar i grupit të menazhimit të krizave, në nivel shkolle dhe DAR-i.				
		2.2.3. Disponon raportet e punës këshilluese, në nivel individual dhe në grup.				
		2.2.4. Organizon dhe merr pjesë në veprimtaritë për trajnimin e mësuesve, të prindërve dhe të nxënësve.				
		2.2.5. Organizon dhe merr pjesë në veprimtaritë për orientimin profesional të nxënësve.				
		2.2.6. Siguron bashkëpunëtorë, brenda dhe jashtë shkollës, për realizimin e ndërhyrjeve të parashikuara.				
		2.2.7. Këshillimi i ofruar mbulon me përparësi çështje të tilla, si: vështirësitë në ecurinë në mësim, këshillimin e mësuesve dhe të prindërve për trajtimin e fëmijëve dhe të adoleshentëve, këshillimin e nxënësve për sjelljen dhe				

	mirëqenien personale.				
	2.2.8. Disponon një kalendar aktiviteteve për rritjen e aftësisë mësimdhënëse të mësuesve.				
	2.2.9. Merret me trajnimin e mësuesve, me përparësi, për çështjet e trajtimit të nxënësve.				
	2.2.10. Mbështet bashkëpunimin shkollë – familje.				
	2.2.11. Këshillon prindërit për problematika specifike të fëmijëve të tyre.				
	2.2.12. Organizon veprimtari për orientimin profesional të nxënësve dhe të prindërve.				
	2.2.13. Organizon takime me prindër, sipas nevojave që ata kanë, për të përmirësuar shprehitë e prindërimit dhe të ndërtimit të marrëdhënieve me adoleshentët.				
	2.2.14. Ofron këshillim profesional për problematikat e lindura nga incidente kritike, si: vdekja, vjedhja, kërcënimi, thashethemet, katastrofat, dhuna, përdhunimi, përshtatja, konfliktet, droga etj.				
	2.2.15. Merret me promovimin e strategjive optimale të të nxënësve.				
	2.2.16. Realizon veprimtaritë përkatëse për vlerësimin e nevojave për këshillim.				
	2.2.17. Ofron trajnime për inteligjencën emocionale dhe shkathtësitë sociale.				
	2.2.18. Propozon veprimtari për trajtimin në grup të disa prej çështjeve që zbulohen në këshillimin individual.				
	2.2.19. Bashkëpunon me psikologët e tjerë shkollorë, për të ofruar paketa të fokusuara trajnime, në përshtatje me nevojat e zbuluara.				

		2.2.20. Ndërmerr nisma që synojnë zhvillimin e bashkëpunimit shkollë-familje apo që favorizojnë një proces bashkëpunimi midis palëve.				
3. Psikologu shkollor punon me një etikë që respekton interesin më të lartë të klientit dhe të institucionit.		2.2.21. Demonstron respekt të pakushtëzuar ndaj klientit (nxënësit).				
		2.3.2. Koncepton këshillimin si proces ku individi përfshihet vullnetarisht.				
		2.3.3. Njeh dhe respekton parimin e konfidencialitetit me të gjitha limitet e tij.				
		2.3.4. Ndërton një sistem pune, që garanton ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit të klientëve.				
		2.3.5. Respekton rezistencat e klientit.				
		2.3.6. Siguron lejen e prindërve për t'u ofruar këshillim të kujdesshëm fëmijëve të tyre.				
		2.3.7. Ndërhyn në mbrojtje të interesit më të lartë të klientit.				
		2.3.8. Dëshmon se di të reagojë në lidhje me vlerat e klientit (nxënësit).				
		2.3.9. Njeh komplikacionet e mundshme etike dhe ligjore të punës këshilluese.				
		2.3.10. Propozon përmirësime të procedurave dhe të qëndrimeve në dobi të zhvillimit pozitiv.				
		2.3.11. Kujdeset që kërkimi shkencor në shkollë të marrë miratimin e nevojshëm për respektimin e etikës së kërkimit.				
		2.3.12. Kujdeset të mos konsumohet nga puna psikologjike, duke menazhuar ngarkesën dhe duke alternuar angazhimet.				
		2.3.13. Kujdeset që të jetë i ndërgjegjshëm për kufizimet e				

	procesit të këshillimit.				
	2.3.14. Bën përpjekje të njohë veten e tij dhe sidomos kufizimet në shkathtësitë e tij këshilluese.				
	2.3.15. Merr përsipër të kryejë vetëm ato ndërhyrje, për të cilat ai ka kompetencën e nevojshme.				
	2.3.16. Referon të gjitha rastet e punës, për të cilat ai e ndien që nuk ka formimin dhe eksperiencën për t'i përballuar.				
	2.3.17. Në rastet e krizave shkollore, ai nisat nga parimi i minimizimit të dëmit dhe i maksimizimit të përfitimit.				
	2.3.18. Kujdeset që vendimet të merren vetëm mbi bazën e të dhënave të konfirmuara.				
	2.3.19. Kujdeset që të respektohet kufiri midis marrëdhënies profesionale dhe personale në institucion.				

STANDARDI

Psikologët shkollorë kanë formimin e nevojshëm, për të ofruar këshillim për aktorët shkollorë në fushat e mirëqenies psikologjike, të sjelljes, zhvillimit dhe incidenteve kritike në jetë. Këshillimi i tyre dhe referimi për trajtime të specializuara synon t'i ndihmojë ata të administrojnë emocionet dhe sjelljen, të reagojnë në mënyra të shëndetshme në shkollë, në familje dhe në shoqëritë e tyre. Pjesë e punës së tyre këshilluese janë prindërit dhe mësuesit. Psikologu shkollor i ndihmon ata të kuptojnë çështjet zhvillimore dhe vështirësitë që kanë nxënësit, si dhe të reagojnë në mënyrë të tillë që nxënësit të përballojnë vështirësitë e jetës, të cilat nuk i lejojnë ata të çlirojnë gjithë potencialin që kanë. Puna këshilluese u ofrohet si individëve ashtu edhe grupeve. Psikologët shkollorë i japin përparësi punës në grupe (“psikoedukim”: mbështetje, sensibilizim, trajnim; trajtim) dhe e realizojnë këshillimin individual si një veprimtari mbështetëse.

Niveli 1

Psikologu shkollor pothuajse gjithmonë zotëron, shpreh, argumenton konceptet e tij mbi thelbin, rolin, kufizimet e këshillimit, si një nga fushat e punës së tij në shkollë. Psikologu shkollor pothuajse gjithmonë zotëron dhe demonstroi përdorimin e një liste të larmishme

shkathtësish, për t'u ofruar këshillime të frytshme aktorëve me të cilët bashkëpunon. Psikologu shkollor pothuajse gjithmonë përfshihet në veprimtari individuale e në grupe këshilluese për çështjet mësimore, zhvillimore e të mirëqenies së aktorëve shkollorë, si dhe të proceseve që organizohen për ta. Pothuajse gjithmonë, ai kujdeset që veprimtaria e vet të jetë e planifikuar dhe e dokumentuar. Psikologu shkollor, gjatë punës së tij këshilluese, pothuajse gjithmonë kujdeset që të respektojë klientët, privatësinë e tyre, të jetë konfidencial dhe të punojë për interesin më të lartë të klientit dhe të institucionit.

Niveli 2

Psikologu shkollor herë pas here zotëron, shpreh, argumenton konceptet e tij mbi thelbin, rolin, kufizimet e këshillimit, si një nga fushat e punës së tij në shkollë. Psikologu shkollor herë pas here zotëron dhe demonstroi përdorimin e një liste të larmishme shkathtësish, për t'u ofruar këshillime të frytshme aktorëve me të cilët bashkëpunon.

Psikologu shkollor herë pas here përfshihet në veprimtari individuale e në grupe këshilluese për çështjet mësimore, zhvillimore, të mirëqenies së aktorëve shkollorë, si dhe të proceseve që organizohen për ta. Herë pas here, ai kujdeset që veprimtaria e vet të jetë e planifikuar dhe e dokumentuar. Psikologu shkollor, gjatë punës së tij këshilluese, herë pas here kujdeset që të respektojë klientët, privatësinë e tyre, të jetë konfidencial dhe të punojë për interesin më të lartë të klientit dhe të institucionit.

Niveli 3

Psikologu shkollor nganjëherë zotëron, shpreh, argumenton konceptet e tij mbi thelbin, rolin, kufizimet e këshillimit, si një nga fushat e punës së tij në shkollë. Psikologu shkollor nganjëherë zotëron dhe demonstroi përdorimin e një liste të larmishme shkathtësish, për t'u ofruar këshillime të frytshme aktorëve me të cilët bashkëpunon. Psikologu shkollor nganjëherë përfshihet në veprimtari individuale e në grupe këshilluese për çështjet mësimore, zhvillimore, të mirëqenies së aktorëve shkollorë, si dhe të proceseve që organizohen për ta. Nganjëherë, ai kujdeset që veprimtaria e vet të jetë e planifikuar dhe e dokumentuar. Psikologu shkollor, gjatë punës së tij këshilluese, nganjëherë kujdeset që të respektojë klientët, privatësinë e tyre, të jetë konfidencial dhe të punojë për interesin më të lartë të klientit dhe të institucionit.

Niveli 4

Psikologu shkollor rrallëherë zotëron, shpreh, argumenton konceptet e tij mbi thelbin, rolin, kufizimet e këshillimit, si një nga fushat e punës së tij në shkollë. Psikologu shkollor rrallëherë zotëron dhe demonstroi përdorimin e një liste të larmishme shkathtësish, për t'u

ofruar këshillime të frytshme aktorëve me të cilët bashkëpunon. Psikologu shkollor rrallëherë përfshihet në veprimtari individuale e në grupe këshilluese për çështjet mësimore, zhvillimore, të mirëqenies së aktorëve shkollorë, si dhe të proceseve që organizohen për ta. Rrallëherë, ai kujdeset që veprimtaria e vet të jetë e planifikuar dhe e dokumentuar. Psikologu shkollor, gjatë punës së tij këshilluese, rrallëherë kujdeset që të respektojë klientët, privatësinë e tyre, të jetë konfidencial dhe të punojë për interesin më të lartë të klientit dhe të institucionit.

Fusha V: ZHVILLIMI PROFESIONAL I PSIKOLOGUT SHKOLLOR

Praktika e përditshme e punës shkollore nxjerr vazhdimisht probleme që kërkojnë angazhime dhe zgjidhje në nivelin praktik dhe në nivelin e kërkimit. Profesion i psikologut shkollor zhvillohet si të gjithë profesionet e tjera me prurje, si nga studimet shkencore, ashtu edhe nga praktika më e mirë. Aktorë të procesit të zhvillimi profesional janë vetë psikologët.

Psikologët shkollorë punojnë për zhvillimin personal profesional, për të qenë vazhdimisht të informuar për zhvillimet në profesion. Zhvillimi i tyre profesional nënkupton njohjen e thelluar të kërkimeve në fushën e aktivitetit të psikologut shkollor. Për këtë, psikologët shkollorë njihen me përfundimet e studimeve të ndryshme shkencore, studiojnë periodikët dhe botimet që dalin, ndjekin konferencat shkencore dhe trajnimet që ofrohen për të përparuar dhe shtuar njohuritë në fushën e tyre.

Psikologët shkollorë zhvillohen duke reflektuar mbi përvojën personale. Si rregull, ata i kushtojnë vëmendje praktikës personale më të mirë, si dhe aktiviteteve me të cilat shmangen praktikat e varfra. Në këtë proces psikologët shkollorë studiojnë rastet me të cilat ata punojnë, si në vlerësim, planifikim, konsultim, këshillim; analizojnë përvojën personale dhe vendosin se cilat përvoja të mira duhet të ofrojnë për një shërbim të frytshëm në të mirë të subjekteve, por dhe të komunitetit shkollor. Në këtë drejtim, ata planifikojnë kohën për punë individuale.

Psikologët shkollorë zhvillohen duke shkëmbyer përvojat e dhura profesionale me njëri-tjetrin. Në këtë drejtim, ata mblidhen dhe diskutojnë rregullisht, organizojnë takime, seminare, simpoziume, marrin pjesë në forume e organizime profesionale. Ata mbështetin njëri-tjetrin në përpjekjet për të çuar përpara profesionin dhe për t'u dhënë zgjidhje çështjeve të praktikës.

Në përpjekjet për të avancuar profesionalisht, psikologët shkollorë organizohen në shoqata, veprojnë të organizuar, mbrojnë interesat e tyre dhe të shërbimit për komunitetin shkollor, sistemojnë dhe publikojnë punën dhe kërkimet e tyre, planifikojnë dhe marrin arsim të mëtejshëm, kërkojnë dhe sigurojnë mbikëqyrje etj.

Nënfushat përbërëse të *Zhvillim profesional të psikologut shkollor* janë:

- a) Trajnimi dhe kualifikimi zyrtar i psikologut shkollor,
- b) Informimi në lidhje me zhvillimet e fundit në profesionin e tij,
- c) Reflektimi mbi përvojën personale,
- d) Shkëmbimi i përvojës me kolegët,
- e) Organizimi në bashkësi profesionale

Nënfusha 1: Trajnimi dhe kualifikimi zyrtar i psikologut shkollor

Drejtuesit e institucionit arsimor kanë përgjegjësi zyrtare për të mbështetur zhvillimin e vazhdueshëm profesional të psikologut shkollor. Nevojat për trajnim dhe kualifikim të psikologut shkollor identifikohen në kohë dhe marrin parasysh, në mënyrë të ekuilibruar nevojat, pikat e dobëta dhe të forta që psikologët paraqesin për veprimtarinë e tyre profesionale. Për këtë punohet me rrjetin profesional të psikologëve shkollorë, duke hartuar një plan trajnimi të specifikuar për këtë grup interesi dhe për personat/subjektet që do të bëjnë mbikëqyrjen e tyre. Drejtuesit e shkollës planifikojnë në planin vjetor, në planin afatmesëm të shkollës, planin e trajnimeve dhe të kualifikimit të psikologut shkollor, si dhe bashkëpunojnë ngushtë me qeverisjen lokale arsimore, për mbështetjen e trajnimit të psikologut shkollor.

Zhvillimi profesional i psikologut shkollor arrihet në dy rrugë:

- a) *Me studim dhe zhvillim individual,*
- b) *Me trajnim.*

Studimi dhe zhvillimi individual është përpjekja personale e psikologut për t'u zhvilluar profesionalisht. Ai pritet të jetë vetë i interesuar që ta bëjë këtë gjë, duke menduar që me këtë investim ai nuk i shërben vetëm vetes së tij, por edhe subjekteve me të cilat ai punon, si dhe vetë institucionit.

Zhvillimi profesional i psikologut shkollor realizohet edhe pranë institucioneve të licencuara, të cilat i pajisin në fund me një dëshmi, e cila ka vlerë dhe shihet me përparësi nga institucionet arsimore. Për kualifikimin, psikologut shkollor i jepet, fillimisht, programi i zhvillimit profesional, literatura përkatëse, materiale të ndryshme shkencore. Ashtu si mësuesit, edhe psikologu shkollor i nënshtrohet provimit që përmban disa modalitete, të cilat, nëse i plotëson, fiton një shkallë më të lartë kualifikimi. Përmbajtja e programeve për formimin profesional fillestar dhe në vazhdim i psikologut shkollor, orientohet nga standardet profesionale zyrtare të psikologut shkollor.

Nënfusha 2: Informimi në lidhje me zhvillimet e fundit në profesionin e tij

Psikologu shkollor bën përpjekje të vazhdueshme për të qenë i informuar dhe në kontakt me zhvillimet dhe risitë në fushën e shërbimit psikologjik në shkollë. Ai ndjek me kuriozitet publikimet e ndryshme të natyrës psikologjike, studime, gjetje të përvojave të suksesshme dhe bashkëkohore të trajtimit psikologjik të aktorëve shkollorë. Nga ana tjetër, psikologu shkollor është gjithnjë i informuar rreth veprimtarive trajnuese dhe shkencore, brenda dhe jashtë vendit, që lidhen me fushën e tij dhe krijon mundësi për të marrë pjesë në to. Po ashtu, ai siguron që në veprimtari të tilla të paraqesë përvojën e tij, si dhe të japë ide, gjykime dhe këndvështrime profesionale, që e lehtësojnë atë, për shërbimin që ofron në shkollë.

Nënfusha 3: Reflektimi mbi përvojën personale

Psikologu shkollor bën përpjekje që të reflektojë mbi përvojën individuale që grumbullon, e cila arrihet me këmbëngulje, me motivim e kujdes profesional. Përvoja individuale e punës së psikologut shkollor përbën një burim të çmuar, nga e cila ai nxjerr mësimet përkatëse. Psikologu zbulon në këtë proces mësimet më të mira që mund të ketë identifikuar në procese psikologjike të tilla, si: këshillimi, planifikimi, analiza individuale etj. Në rastet kur vëren se përvoja apo modeli i përdorur gjatë një trajtimi psikologjik apo proces tjetër i shërbimit të tij, nuk është i frytshëm, ai bën menjëherë analiza dhe reflektime, për të gjetur apo për të përdorur rrugë të tjera, të cilat synojnë rezultatet e dëshiruara.

Nënfusha 4: Shkëmbimi i përvojës me kolegët

Psikologu shkollor mban kontakte të vazhdueshme me psikologë të tjerë të profilit të tij, duke shkëmbyer me ta pikëpamje, përvoja të trajtimeve të veçanta psikologjike që kanë rezultuar të frytshme, si dhe informojnë njëri-tjetrin për risi dhe zhvillime të kohës në fushën e shërbimit psikologjik. Psikologu shkollor merr pjesë në takimet e ekipeve kurrikulare dhe lëndore të shkollës për të informuar mësuesit-kolegë rreth problemeve të mundshme që subjektet kanë shfaqur në trajtimet psikologjike, të cilat lidhen me ngarkesën e mundshme kurrikulare, por edhe me shkaktarët e vështirësive në të nxënë të nxënësve. Ai shkëmben ide dhe pikëpamje profesionale me mësuesit kujdestarë, për të plotësuar sa më gjerë njohjet e tij për rrethanat familjare dhe sociale të subjekteve që ai trajton. Psikologët shkollorë aftësohen duke shkëmbyer përvojat e duhura profesionale me njëri-tjetrin. Në këtë drejtim, ata mblidhen dhe diskutojnë rregullisht, organizojnë takime, seminare, simpoziume, marrin pjesë në forume e organizime profesionale. Ata mbështetin njëri-tjetrin në përpjekjet për të çuar përpara profesionin dhe për t'u dhënë zgjidhje çështjeve të praktikës.

Nënfusha 5: Organizimi në bashkësi profesionale

Psikologu shkollor bashkëpunon dhe me organizma të tjerë profesionalë, jashtë institucionit arsimor parauniversitar, ku ai punon. Ky bashkëpunim duhet të synojë që të nxisë te psikologu dëshirën për të zhvilluar dhe për të pasuruar rritjen e tij si individ e si grup profesional. Po ashtu, ai pritët të krijojë mundësi dhe të gjejë rrugë bashkëpunimi me universitetet që përgatitin psikologë, si dhe të motivohet për t'u përfshirë në projekte edukimi në organizata jofitimprurëse që veprojnë në zonën ku ai punon, por dhe jashtë vendit. Psikologu pritët të bëjë çmos që të marrë pjesë në veprimtari shkencore, në konferenca, workshope, trajnime online ose lloje të tjera trajnimesh, të cilat lidhen ngushtë me shërbimin që ai ofron. Nga ana tjetër, ai pritët të ekspozojë praktikat e mira të shërbimit të tij në veprimtari të ndryshme shkencore ose trajnuese. Psikologu shkollor pritët të përfshihet në rrjetin profesional të psikologëve shkollorë. Kjo është një mundësi që i jepet çdo profesioni që merret me edukimin e nxënësve në shkollë. Psikologët shkollorë, të organizuar, po të paraqiten si grup profesional, mund të mbrojnë interesat e tyre dhe të shërbimit për komunitetin shkollor, duke e avancuar profesionin edhe si grup.

Nënfusha 1	Treguesit	Instrumentet	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
Trajnimi dhe kualifikimi zyrtar i psikologut shkollor	1. Shkolla identifikon nevojat për trajnim të psikologut.	1.1.1. Psikologu shkollor ka kërkuar trajnim të vijueshëm.				
		1.1.2. Është bërë identifikimi i nevojave reale të psikologut shkollor për trajnim.				
		1.1.3. Janë përcaktuar drejtimet dhe kërkesat e psikologëve për trajnim.				
		1.1.4. Nuk ka ndryshime mes nevojave për trajnim, të identifikuara nga drejtoria e shkollës dhe atyre, të kërkuara nga psikologu.				
		1.1.5. Shkolla ka të dhëna të sakta për shkallën e kualifikimit të psikologut shkollor.				
		1.1.6. Shkolla komunikon me institucionet e DAR/ZA-së për nevojat e identifikuara.				
		1.1.7. Psikologu shkollor i paraqet nevojat dhe tematikat për trajnim edhe tek rrjeti profesional i psikologëve në nivel lokal.				
	2. Shkolla realizon planifikimin e trajnimit dhe mbështet kualifikimin e psikologut.	1.2.1. Shkolla zhvillon trajnime për psikologun e saj sipas një plani të posaçëm.				
		1.2.2. Shkolla përcakton grupe psikologësh dhe mësuesish për trajnime sipas nevojave të tyre.				
		1.2.3. Shkolla bashkëpunon me specialistë apo institucione që ofrojnë ndihmë, në drejtim të trajnimit të psikologut shkollor.				
		1.2.4. Shkolla mbështet me përparësi psikologët, të cilët				

		do t'i nënshtrohen kualifikimit për fitimin e një shkalle më të lartë.				
--	--	--	--	--	--	--

Nënfusha 2	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
Informimi për zhvillimet në fushën profesionale	1. Psikologu shkollor është i informuar për risitë dhe përvojat bashkëkohore të shërbimit psikologjik në shkollë.	2.1.1. Psikologu shkollor ka identifikuar përvoja bashkëkohore, të frytshme për trajtimin psikologjik të subjekteve.				
		2.1.2. Psikologu shkollor ruan në dosjen/bibliotekën e tij personale materiale profesionale të tilla, si: studime, shkrime shkencore, gjetje të suksesshme në fushën e trajtimit psikologjik në shkollë etj.				
		2.1.3. Psikologu shkollor është i informuar vazhdimisht për programet dhe trajnimet që lidhen me punën e tij në zonën ku punon, por dhe për aktivitete të tjera, brenda dhe jashtë vendit.				
		2.1.4. Psikologu shkollor kërkon dhe ndjek online materiale dhe botime profesionale për punën e tij.				

Nënfusha 3	Treguesit	Instrumentet	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
		3.1.1. Psikologu shkollor ruan në një dosje të veçantë të gjitha rastet që i ka konsideruar të suksesshme në trajtimin psikologjik të subjekteve.	1	2	3	4

	shërbimit psikologjik refleksionet e tij, të krijuara nga përvoja personale, por edhe nga vlerësimi i vijueshëm i rezultateve që arrin.	3.1.2. Psikologu shkollor shqyrton me kujdes përvojat pozitive të identifikuara për trajtimin psikologjik të subjekteve.				
		3.1.3. Psikologu shkollor, në rastet kur trajtimi psikologjik i nxënësit nuk është i suksesshëm, bën analiza dhe përdor rrugë e forma të tjera trajtimi në punën me të.				

Nënfusha 4	Treguesit	Instrumentet	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
Shkëmbimi i përvojës me kolegët	1. Psikologu shkollor shkëmben pikëpamjet dhe përvojat e tij të shërbimit psikologjik me kolegë të profesionit, por edhe me mësues e organizma zyrtarë të shkollës.	4.1.1. Psikologu zhvillon takime të rregullta me kolegë-psikologë për të shkëmbyer përvoja profesionale.				
		4.1.2. Psikologu shkollor merr pjesë në takimet e ekipeve kurrikulare dhe lëndore, si dhe me mësues kujdestarë, ku paraqet idetë e tij për probleme të shërbimit psikologjik të fëmijëve-nxënës.				
		4.1.3. Psikologu shkollor është i motivuar për të marrë pjesë në lloje të ndryshme veprimtarish, ku shkëmbehen përvoja profesionale.				

		4.1.4. Psikologu shkollor ruan në një dosje, materiale të vlefshme për shërbimin e tij, të cilat i ka marrë apo shkëmbyer me kolegë të ndryshëm.				
--	--	--	--	--	--	--

Nënfusha 5	Treguesit	Instrumentet	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
Organizimi në bashkësi profesionale	1. Psikologu shkollor merr pjesë aktivisht në rrjetin profesional, lokal dhe kombëtar të psikologëve shkollorë.	5.1.1. Psikologu është anëtar i rrjetit profesional lokal dhe kombëtar të psikologëve shkollorë.				
		5.1.2. Psikologu shkollor është i informuar dhe i pajisur me planin e veprimtarive të rrjetit profesional të psikologëve shkollorë.				
		5.1.3. Psikologu shkollor merr pjesë në të gjitha veprimtaritë e planifikuara nga rrjeti profesional i psikologëve.				
		5.1.4. Psikologu shkollor komunikon online dhe me shkrim me rrjetin profesional të psikologëve shkollorë.				
		5.1.5. Psikologu shkollor paraqet në rrjetin e psikologëve ose publikon në botimet e këtij rrjeti përvojën e tij ose praktika, që i konsideron të suksesshme për shërbimin psikologjik.				
	2. Shkolla realizon planifikimin e trajnimit dhe mbështet kualifikimin e psikologut.	5.2.1. Psikologu shkollor, bashkë me kolegë të tij, krijojnë shoqata dhe organizma që mbështetin zhvillimin e tyre profesional.				
		5.2.2. Psikologu shkollor bashkëpunon me universitetet që formojnë psikologë, brenda dhe jashtë vendi.				
		5.2.3. Psikologu shkollor bashkëpunon, sipas mundësive që i krijohen, me OJF të vendit dhe të huaja, të cilat kanë				

	në fokus shërbimin psikologjik.				
	5.2.4. Psikologu shkollor merr pjesë në veprimtari shkencore, si: konferenca, workshope, trajnime etj.				
	5.2.5. Psikologu shkollor publikon kërkimet, gjetjet dhe përvojat e tij, të cilat mund të konsiderohen praktika të mira të shërbimit psikologjik, në veprimtari shkencore ose në publikime profesionale.				
	5.2.6. Psikologu shkollor ruan në dosje gjetjet e ndryshme profesionale dhe rezultatet e kërkimeve gjatë shërbimit të tij				

STANDARDI

Psikologu shkollor punon për zhvillimin e tij profesional për të qenë vazhdimisht i informuar me zhvillimet në profesion. Ai paraqet gjithnjë nevojat e tij për zhvillim profesional. Psikologu shkollor merr pjesë në rrjetin profesional, lokal dhe kombëtar të psikologëve shkollorë. Ai realizon vetëtrajnimin e tij përmes studimit dhe kontakteve online. Në këtë rol, ai planifikon fusha të caktuara zhvillimi profesional duke studiuar individualisht, duke u konsultuar, duke marrë trajnime sipas mundësisë, dhe duke planifikuar kohë për punë individuale, duke marrë pjesë në forume e organizime profesionale, duke planifikuar e kryer studime të mëtejshme, duke siguruar mbikëqyrje, si dhe duke u përfshirë në kërkime e në publikime të përvojës personale në veprimtari shkencore. Psikologu shkollor shkëmben përvojat e tij me kolegë të tjerë, ruan dhe grumbullon praktika të suksesshme, duke i reflektuar ato edhe në shërbimin e tij. Psikologu shkollor përmbush detyrimet për kualifikimin e tij sipas kërkesave zyrtare, duke u mbështetur dhe nga shkolla ku punon.

Niveli 1

Psikologu shkollor është shumë i interesuar për zhvillimin e tij profesional. Ai paraqet gjithnjë nevojat e tij reale për zhvillimin profesional. Psikologu shkollor merr pjesë aktive në rrjetin profesional lokal dhe kombëtar të psikologëve shkollorë. Ai përdor forma të shumëllojshme për vetëtrajnim, si dhe planifikon e realizon trajnimin e vijueshëm të tij. Merr pjesë aktive në organizma dhe zbatime projektesh edukimi që lidhen me shërbimin e tij. Psikologu shkollor shkëmben gjithnjë përvojat e tij me kolegë të tjerë, ruan dhe grumbullon vazhdimisht praktika të suksesshme, duke i reflektuar ato në mënyrë shumë rezultative në shërbimin e tij. Ai i fiton

lehtësisht shkallët e kualifikimit sipas kërkesave zyrtare. Psikologu shkollor mbështetet përherë nga shkolla për trajnimin dhe kualifikimin e tij të vazhdueshëm.

Niveli 2

Psikologu shkollor është i interesuar për zhvillimin e tij profesional. Ai paraqet me kohë nevojat për zhvillimin profesional. Psikologu shkollor merr pjesë në rrjetin profesional, lokal dhe kombëtar të psikologëve shkollorë. Ai planifikon dhe përpiqet për trajnimin e vijueshëm të tij. Merr pjesë në organizma dhe zbatime projektsh edukimi që lidhen me shërbimin psikologjik. Ai shkëmben, kur e ka të domosdoshme, përvojat e tij me kolegë të tjerë. Nuk ruan sistematikisht praktikrat dhe përvojat e suksesshme dhe i reflekton ato, vetëm kur ndodhet në një situatë “sfiduese” në shërbimin e tij. Psikologu shkollor i fiton shkallët e kualifikimit sipas kërkesave zyrtare. Ai nuk është i mbështetur sa duhet nga shkolla për trajnimin dhe kualifikimin e tij të vazhdueshëm.

Niveli 3

Psikologu shkollor shfaq me raste interes për zhvillimin e tij profesional. Ai nuk paraqet me kohë nevojat e tij për zhvillim profesional. Psikologu shkollor nuk merr pjesë rregullisht në rrjetin profesional lokal dhe kombëtar të psikologëve shkollorë. Ai planifikon, por nuk përpiqet sa duhet për trajnimin e vijueshëm të tij. Nuk angazhohet në organizma dhe zbatime projektsh edukimi që lidhen me shërbimin psikologjik. Ai i shkëmben ndonjëherë përvojat e tij me kolegë të tjerë. Nuk i ruan në vijimësi praktikrat dhe përvojat e suksesshme dhe pothuajse nuk i reflekton ato në shërbimin e tij. Psikologu shkollor i fiton me vështirësi shkallët e kualifikimit sipas kërkesave zyrtare. Ai nuk është i mbështetur nga shkolla për trajnimin dhe kualifikimin e tij të vazhdueshëm.

Niveli 4

Psikologu shkollor nuk ka interes për zhvillimin e tij profesional. Ai nuk i paraqet nevojat e tij për zhvillim profesional. Psikologu shkollor nuk merr pjesë në rrjetin profesional lokal dhe kombëtar të psikologëve shkollorë. Ai nuk planifikon dhe nuk përpiqet për trajnimin e vijueshëm të tij. Nuk angazhohet në organizma dhe zbatime projektsh edukimi që lidhen me shërbimin psikologjik. Psikologu shkollor shkëmben në ndonjë rast përvojat e tij me kolegë të tjerë. Nuk i ruan praktikrat dhe përvojat e suksesshme dhe nuk i reflekton ato në shërbimin e tij. Psikologu shkollor përsërit disa herë provimin për të fituar shkallët e kualifikimit sipas kërkesave zyrtare. Ai nuk mbështetet asnjëherë nga shkolla për trajnimin dhe kualifikimin e tij të vazhdueshëm.

BAZA LIGJORE

1. Ligj Nr. 69/2012, “Për Sistemin Arsimit Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”.
2. Udhëzimi Nr. 18, datë 21.04.2008, “Për funksionimin e shërbimit psikologjik shkollor në sistemin arsimor parauniversitar”.
3. Urdhër Nr. 170, datë 21.04.2008, “Për funksionimin e shërbimit psikologjik shkollor në sistemin arsimor parauniversitar”.
4. Inspektorati Kombëtar i Arsimit Parauniversitar, “Inspektimi dhe vlerësimi i brendshëm i shkollës”, Tiranë, 2011.
5. Inspektorati Kombëtar i Arsimit Parauniversitar, “Inspektimi dhe vlerësimi i brendshëm i kopshtit”, Tiranë, 2011.
6. Inspektorati Kombëtar i Arsimit Parauniversitar, “Inspektimi dhe vlerësimi i brendshëm i DAR/ZA-së”, Tiranë, 2011.

BIBLIOGRAFIA

1. Inspektorati Kombëtar i Arsimit Parauniversitar, “Metodologjia e inspektimit dhe e vlerësimit të brendshëm të Institucioneve Arsimore Parauniversitare”, Tiranë, 2011.
2. Lionetti, M. T., Snyder P. E., Christner W. R., A practical guide to building professional competencies in school psychology Springer, 2011.
3. Merrell, K. W., Ervin, R. A., & Gimpel, G. A., School psychology for the 21st century: Foundations and practices. New York: The Guilford Press, 2006.
4. Peacock, G., Merrell K., Practical Handbook of School Psychology: Effective Practices for the 21st Century The Guilford Press, 2010.
5. Tamo, A., Nga kriza shkollore te trauma psikologjike, albPAPER, Tiranë, 2012.
6. Tamo, A., Kamani, P., Nano, V., Tahsini, I., & Agolli, I., Raport i vlerësimit të shërbimit psikologjik shkollor, Tiranë, 2006.
7. Trombetta, C., Alessandri, G., & Coyne, J., Italian School Psychology as Perceived by Italian School Psychologists: The Results of a National Survey. School Psychology International, 2008.

WEBLIOGRAFIA

1. <http://caspsurveys.org/NEW/pdfs/nasp01.pdf>
2. http://det.Wa.edu.au/redirect/?oid=com.arsdigita.cms.contenttypes.FileStorageItem-id 11959068&stream_asset=true
3. http://det.wa.edu.au/studentsupport/behaviourandwellbeing/detcms/cms-service/download/asset/?asset_id=11751735
4. [http://ncees.ncdpi.wikispaces.net/file/view/School+Psychologist+Evaluation+Instrument+Training+2012+Version+\(2\).pdf](http://ncees.ncdpi.wikispaces.net/file/view/School+Psychologist+Evaluation+Instrument+Training+2012+Version+(2).pdf)
5. <http://www.bcps.org/offices/sss/psManual/PS402.PDF>
6. <http://www.cpa.ca/cpaside/userfiles/Documents/publications/CPA%20Guideline%20Practice.pdf>
7. <http://www.gnb.ca/0000/publications/ss/Guidelines%20for%20Professional%20Practice%20for%20School%20Psychologists.pdf>
8. http://www.nasponline.org/about_nasp/positionpapers/Supervision_in_School.pdf
9. <http://www.nasponline.org/publications/booksproducts/PPFV3%20Ch%204.pdf>
10. http://www.nasponline.org/standards/practice-model/Practice_Model_Brochure.pdf
11. <http://www.psychology.org.au/Assets/Files/Framework-school-psychological-services.pdf>
12. <http://www.sde.ct.gov/sde/lib/sde/PDF/DEPS/Student/PsychSocial/GuidelinesSchoolPsychology.pdf>
13. http://www.studentservices.ednet.ns.ca/sites/default/files/School_Psych_Guide.p

